

# RAPORTI VJETOR I INTEGRUAR 2022

---

ANTEA CEMENT SH.A





## 01 ÇËSHJET KRYESORE TË 2022 (6)

## 02

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM (8)

# 03

## PËRMBLEDHJE (10)

Qasja jonë drejt një mjedisi në ndryshim (11)  
Vlerat tona thelbësore (15)  
Strategjia e grupit TITAN: Rritja e biznesit tonë, përqendrimi tek klientët, zhvillimi i talentit tonë (16)  
Prania globale e Grupit TITAN (18)  
Promovimi dhe ndarja e vlerave (20)  
Të punojmë së bashku për zhvillim të qëndrueshëm (22)  
Prodhojmë ÇIMENTO, ofrojmë FUQI! (25)  
Rreth Antea Cement (26)  
Historiku i ANTEA (28)

# 04

## PIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS SË ANTEA (30)

## 05

## RAPORTI I MENAXHIMIT (36)

Qeverisja e korporatave dhe menaxhimi i rrezikut (37)  
Bordet dhe Komitetet Drejtuese të ANTEA-s (40)  
Auditimet e ANTEA dhe Menaxhimi i Rrezikut (42)  
Menaxhimi i Rrezikut (43)

## 06

## RISHIKIMI I PERFORMANCËS FINANCIARE (46)

Pasqyrat Financiare (47)



## 07 PASQYRË E KONSOLIDUARE NDRYSHIMEVE NË KAPITAL (49)

# 08

## PASQYRA E KONSOLIDUARE FLUKSEVE MONETARE (49)

## 09

## FOKUSIMI NË ÇËSHJET MATERIALE (52)

Objektivat ESG për vitin 2025 dhe në vazhdim (56)

# 10

## PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS SË ESG

Zona e fokusit: De-karbonizimi dhe Dixhitalizimi (60)  
Zona e fokusit: Ambient pune që të ndihmon të rritesh (67)  
Ndikim pozitiv lokal (70)  
Zona e fokusit: Burimet përgjegjëse (79)  
Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit (83)

# 11

## DEKLARATATE PERFORMANCËS ESG (86)

## 12

## RAPORTI I AUDITUESIT (118)

## 13

## FJALOR (122)

# RRETH RAPORTIT

Raporti Vjetor i Integruar 2022 i ANTEA-s mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022 (referuar këtu si 'Raporti'). Në këtë raport Antea Sh. A. (në vijim referuar si ANTEA) përfshin rishikimin e performancës për dy filialet në pronësi të plotë, Alba Cemento Shpk dhe Cementi ANTEA Srl, të cilat operojnë përkatësisht në терминаlet e Tiranës (Shqipëri) dhe Ortonës (Itali), lidhur me prodhimin dhe shpërndarjen e çimentos dhe produkteve të çimentos. Detajet janë ofruar në seksionin "Çështjet kryesore të 2022".

Raporti është në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë së TITAN Cement International S.A. (në vijim referuar si grupi TITAN ose thjesht TITAN), siç specifikohet në lidhje me zbatimin e parimeve të Këshillit Ndërkombëtar të Raportimit të Integruar (IIRC), Komunikimin e Kompaktit Global të OKB për Udhëzuesin e Progresit, Udhëzuesit e Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB (OZHQ-të) 2030. Për më tepër, ANTEA ka përfshirë në qasjen e saj Udhëzuesin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), për të lidhur raportimin e qëndrueshmërisë me objektivat për OZHQ-të, duke ndjekur qasjen e Grupit TITAN. Që nga viti 2020, Grupi gjithashtu filloi raportimin sipas kriterëve të Bordit të Standardeve të Kontabilitetit të Qëndrueshmërisë (SASB), dhe ANTEA ka ndjekur të njëjtën praktikë për garantimin e lidhjes së Deklaratave ESG (KPI-të) me Standardet e SASB.

Raporti është zhvilluar për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e palëve të interesit në lidhje me performancën e Antea-s në fushat Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG). ANTEA operon është në përputhje me qasjen sektoriale globale të Grupit TITAN në lidhje me monitorimin, raportimin dhe verifikimin e deklarimeve të saj mbi performancën në Raport. Për më shumë informacion rreth qasjes dhe standardeve të Grupit TITAN, lutemi vizitoni Raportin Vjetor të Integruar të Grupit TITAN 2022 <https://www.titan-cement.com/newsroom/annualreports/>. Gjithashtu, Grupin TITAN 2022 dhe ANTEA RVI mund t'i gjeni në faqen e internetit të ANTEA [www.anteacement.com](http://www.anteacement.com).



## Financiare

2021

**74.88** në m. EUR  
Të ardhurat e konsoliduara<sup>1</sup>  
**20.82** në m. EUR  
EBTIDA e konsoliduar  
**58.20** në m. EUR  
Shpenzimet e konsoliduara të Furnitorëve

**57.34** në m. EUR  
Shpenzimet individuale të Furnitorëve  
**8.58** në m. EUR  
Taksat individuale për qeverinë qendrore dhe lokale<sup>2</sup>  
**1.39** në m. EUR  
Shpenzimet kapitale të konsoliduara

## Financire

2022

**103.22** në m. EUR  
Të ardhurat e konsoliduara<sup>1</sup>  
**24.63** në m. EUR  
EBTIDA e konsoliduar  
**86.83** në m. EUR  
Shpenzimet e konsoliduara të Furnitorëve

**85.68** në m. EUR  
Shpenzimet individuale të Furnitorëve  
**7.13** në m. EUR  
Taksat individuale për qeverinë qendrore dhe lokale<sup>2</sup>  
**4.80** në m. EUR  
Shpenzimet kapitale të konsoliduara

## Çështjet kryesore të 2022

# 2021-2022

### Mjedisi

**794** (klinker g/t)  
Shkarkimet (NOx) të oksideve specifike të azotit  
**3.6** (klinker g/t)  
Shkarkimet specifike të pluhurit (klinker g/t)  
**199.3** (lt/ton çimentoje)  
Konsumi specifik i ujit

**13.6** (klinker g/t)  
Shkarkimet (SOx) të oksideve specifike të sqfurit  
**646.8** (produkt kg/t)  
Objekti I Shkarkimet specifike Dyoksid karboni CO<sup>2</sup>  
**0.29** në m. Euro  
Investime Mjedisore<sup>3</sup>

### Shëndeti dhe Siguria

**0**  
Humbjet e jetës / SP01L

**1**  
Koha e humbur nga punonjësit e dëmtuar (LTI-të)

**2,107**  
Orët e trajnimit për punonjësit e drejtpërdrejtë

### Mjedisi

**1023** (klinker g/t)  
Shkarkimet (NOx) të oksideve specifike të azotit  
**3.5** (klinker g/t)  
Shkarkimet specifike të pluhurit (klinker g/t)  
**228.5** (lt/ton çimentoje)  
Konsumi specifik i ujit

**15.3** (klinker g/t)  
Shkarkimet (SOx) të oksideve specifike të sqfurit  
**625.3** (produkt kg/t)  
Objekti I Shkarkimet specifike Dyoksid karboni CO<sup>2</sup>  
**3.68** në m. Euro  
Investime Mjedisore<sup>3</sup>

### Shëndeti dhe Siguria

**0**  
Humbjet e jetës / SP01L

**0**  
Koha e humbur nga punonjësit e dëmtuar (LTI-të)

**2,600**  
Orët e trajnimit për punonjësit e drejtpërdrejtë

<sup>1</sup>) Shifrat e konsoliduara lidhen me shifrat financiare të konsoliduara të ANTEA Cement Sh.a dhe dy filialeve të saj Alba Cemento Shpk dhe Cementi ANTEA SRL, të nxjerra nga pasqyrat financiare vjetore dhe të konvertuara në monedhën euro për prezantim në këtë raport, duke përdorur kursin e këmbimit 118,97 euro/ lekë për vitin 2022 dhe 122,52 për vitin 2021.

<sup>1</sup>) Shifrat individuale lidhen me shifrat e Antea Cement Sha të pavarura, të nxjerra nga pasqyrat financiare vjetore dhe të konvertuara në monedhën Euro për prezantimin në këtë raport, duke përdorur kursin e këmbimit 118,97 euro/lekë për vitin 2022 dhe 122,52 euro/lekë për vitin 2021.

<sup>1</sup>) Taksat e pavarura për pushtetin qendror dhe vendor janë marrë nga Pasqyrat Financiare Statutore të shoqërisë dhe janë përgatitur sipas udhëzimeve në nenin 21 të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare nr. 25/2018 datë 10.05.2018, siç zbatohet për periudhat raportuese, duke filluar nga viti 2019. Këta numra janë konvertuar në monedhën Euro duke përdorur të njëjtat kurse këmbimi siç përcaktohen më sipër.

## MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM



**MARIO  
BRACCI  
CEO**

Të nderuar palë të interesit,

Procesi i Vërtetimit të materialitetit duke marrë në konsideratë përceptimet e palëve tona të interesit për çështjet më materiale, hodhi themelet për një sërë veprimesh dhe nismash për një vit tjetër rradhaz të qëndrueshëm për ANTEA. Arsimi cilësor, Partneriteti për Objektivat, Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme, Mirëqenia dhe Shëndeti i Mirë si dhe Eliminimi i Varfërisë, ishin OZHQ-të kryesore të trajtuara gjatë gjithë vitit 2022.

Zhvillimi i projekteve komunitare me fëmijë, prindër dhe mësues, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për jetë të shëndetshme, të ardhme më të gjelbër dhe operacione efikase në energji me përfitime të ndërsjella si për biznesin ashtu edhe për vendin, kanë qenë vazhdimisht në fokusin tonë. Ne kemi vazhduar të punojmë së bashku me palët tona të interesit, duke vënë në zbatim plane për angazhimin e komunitetit që frymëzojnë dhe fuqizojnë të rinjtë tanë përmes arsimit cilësor dhe aftësive të reja për zhvillim personal dhe profesional.

Ne besojmë se rritja e angazhimit të punonjësve është thelbësore për rritjen tonë të qëndrueshme. Për këtë arsye, do të donim të merrnim një moment për të falënderuar dhe pranuar se angazhimi, përkushtimi dhe performanca e punonjësve tanë e kanë ndihmuar shoqërinë që të arrijë rezultate të qëndrueshme gjatë gjithë vitit 2022. Përkushtimi për të ruajtur kulturën tonë të etikës dhe integritetit, si dhe standardet e larta të qeverisjes së korporatës bëjnë që ne të punojmë shpejt, të materializojmë përpjekjet tona për të maksimizuar produktivitetin, të përmirësojmë kulturën e punës, të përqafojmë diversitetin dhe të ruajmë talentin më të mirë.

Pritshmëritë tona janë që shoqëria do të ketë rritje dhe po punojmë me përkushtim së bashku me Departamentin e Financave të Grupit TITAN dhe Departamentit të Performancës ESG të Grupit për të siguruar që të gjitha objektivat tona (financiare dhe të qëndrueshmërisë) për vitin 2030 të përmbushen. Edhe për një vit, objektivat e ESG për vitin 2025 dhe më tej qëndrojnë në krye të prioritetëve në përputhje me angazhimin ndaj Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB (OZHQ-të) dhe të Dhjetë Parimeve të Paktit Global të OKB.

***Pritshmëritë tona janë që shoqëria do të ketë rritje dhe po punojmë me përkushtim së bashku me Departamentin e Financave të Grupit TITAN dhe Departamentit të Performancës ESG të Grupit për të siguruar që të gjitha objektivat tona (financiare dhe të qëndrueshmërisë) për vitin 2030 të përmbushen.***

Pavarësisht rrethanave sfiduese, viti 2022 financiarisht rezultoi të ishte një vit pozitiv, duke çuar në një kërkesë të stabilizuar dhe pozitive për çimento në tregun shqiptar si dhe në tregjet e eksportit, krahasuar me nivelet e vitit 2021. Kjo gjendje pozitive e tregut rezultoi në një rritje të xhiros së konsoliduar të shoqërisë për 38%, duke arritur një xhiro totale të konsoliduar prej 103.22 milionë €.

Ngaqë Grupi TITAN është një nga shoqëritë e para të çimentos në mbarë botën me objektiva dekarbonizimi të vërtetuara nga Nisma e Objektiveve të Bazuar në Shkencë (SBTi), ne sigurohemi që të mbajmë nën monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm treguesit tanë mjedisorë duke synuar vazhdimisht arritjen e TKP-ve tona sfiduese. Për më tepër, duke u bashkuar me shoqëritë kryesore ndërkombëtare në përpjekjen për të mbajtur ngrohjen globale në 1.5°C, duke synuar arritjen e zero shkarkimeve neto deri në vitin 2050, adresimi i ndryshimeve klimatike ka mbetur prioriteti kryesor në agjendën tonë të qëndrueshmërisë. Ne jemi të përkushtuar në kërkimin dhe zhvillimin e mënyrave novatore për të krijuar vlerë duke transformuar biznesin tonë, për t'u shërbyer klientëve tanë në mënyrë më eficiente ndërsa shkojmë drejt një bote neutrale ndaj karbonit.

Ndërsa presim me padurim vitin 2023, ne do të kontribuojmë që nga ana jonë Grupi TITAN të ketë aspirata për rritje, duke vepruar gjithmonë me të njëjtën ndjenjë kujdesi për njerëzit tanë, si dhe me përgjegjësi, integritet, përgjegjshmëri dhe respekt.

**Mario Bracci  
CEO**

# PËRMBLEDHJE

## QASJA JONË DREJT NJË MJEDISI NË NDRYSHIM

### QËNDRUESHMËRIA, THEMELI PËR NDËRTIMIN E SË ARDHMES SONË SË BASHKU

Bazuar në përvojën 120-vjeçare të industrisë dhe angazhimin për rritje të qëndrueshme, TITAN u shërben klientëve në 25 vende përmes një rrjeti prej më shumë se 200 qendrash operationale në katër kontinente, duke përfshirë guoret, fabrikat e gatshme, терминаlet dhe objektet e tjera të prodhimit dhe shpërndarjes. Në një botë ku kompleksiteti është në rritje, ne po përshtatemi dhe po evoluojmë për t'i shërbyer nevojave të shoqërisë, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme me përgjegjësi dhe integritet.

# 01

## QASJA JONË NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE



Ne po punojmë me klientët tanë, partnerët e zinxhirit të furnizimit, kolegët dhe palët e tjera të interesit në të gjithë rajonet gjeografike, për të ndihmuar në uljen e ngrohjes globale në 1.5°C dhe për të arritur një ekonomi të balancuar të shkarkimeve deri në vitin 2050. Të përkushtuar ndaj objektivave ambicioze të bazuara në shkencë, ne po reduktojmë vazhdimisht gjurmën tonë të karbonit duke rritur përdorimin e karburanteve alternative, duke përmirësuar eficiencën e energjisë, duke zhvilluar produkte me karbon të ulët dhe duke përkrahur teknologji dhe zgjidhje novatore.

# 02

## QASJA JONË NDAJ TRANSFORMIMIT DIXHITAL



Udhëtimi ynë dixhital deri tani është mundësuar nga inovacioni dhe gatishmëria për të testuar dhe mësuar. Me zgjidhjet e Inteligjencës Artificiale të përshtatura për nevojat e industrisë së çimentos, ne po transformojmë operacionet tona për efikasitet përfundimtar dhe ofrimin e produkteve me cilësi të lartë, me një vështrim në nevojat aktuale dhe të ardhshme të klientëve tanë. Në të njëjtën kohë, ndihmojmë në minimizimin e konsumit të energjisë dhe reduktimin e shkarkimeve të CO<sub>2</sub>, në mbështetje të objektivit tonë të balancimit të shkarkimeve. Mes ndryshimeve të përshpejtuara dhe ngjarjeve shqetësuese, të tilla si pandemia COVID-19, ne trajtojmë në mënyrë efektive sfidat kritike dhe ndërmarim me sukses përbushjen e rolit tonë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë, më të qëndrueshme së bashku me palët e interesit.

# 03

## QASJA JONË PËR RRITJEN E KËRKESËS PËR PRODUKTE DHE SHËRBIME TË QËNDRUESHME



Ndërsa bota po kalon drejt një ekonomie qarkulluese, zero-neto, ne luajmë një rol aktiv në zhvillimin e materialeve dhe zgjidhjeve të ndërtimit të qëndrueshëm, të gjelbër të së ardhmes. Jemi të fokusuar tek përballimi, qëndrueshmëria dhe riciklimi i tyre, si dhe në gjurmën e tyre të karbonit. Gjatë projektimit të tyre, ne vlerësojmë ndikimin mjedisor që ato kanë gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, duke plotësuar nevojat në rritje të klientëve tanë për produkte dhe shërbime të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, inkurajojmë partnerët tanë që të përfshijnë çështjet e qëndrueshmërisë në vendimet e tyre të biznesit dhe sjelljet e përditshme, duke promovuar burime të përgjegjshme në të gjithë mjedisin e zinxhirit të vlerës së krijuar.

# 04

## KRIJIMI I VLERËS PËR TË GJITHA PALËT E INTERESIT



Me objektiva të qarta, të matshme të ESG dhe plane konkrete të vendosura në të gjithë rajonet tona, ne po i përqendrojmë përpjekjet tona në fushat ku veprimet tona dhe zgjidhjet e qëndrueshme mund të kenë ndikimin më të madh pozitiv, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB (OZHQ-të). Për të adresuar sfidat e qëndrueshmërisë, ne kemi bashkuar forcat me palët e interesit lokale dhe globale.

# 05

## RIKRIJIMI I MENAXHIMIT TË TALENTEVE PËR TË KAPUR MUNDËSITË NË NJË BOTË NË NDRYSHIM



Në të gjithë organizatën tonë, ne vazhdojmë të investojmë në programet e talenteve, mirëqenies dhe angazhimit të punonjësve, si dhe në zhvillimin e kulturës sonë. Menaxhimi i shpërblimeve, menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore, programet e përmirësimit dhe rikualifikimit, si dhe përmirësimi i aftësive drejtuese, funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë, dekarbonizimi dhe aftësitë digjitale, inkurajohen të gjitha nga rëndësia e të mësuarit.





## Organizimi mësimor

- Përmirësim i bazës së njohurive
- Afësi performuese në çdo funksion
- Përsosmëri në kompetencat themelore

## Integriteti

- Praktikë etike të biznesit
- Transparenca
- Komunikimi i hapur
- Qeverisja e mirë

## Vlera e konsumatorit

- Pritshmëria e nevojave të klientit
- Zgjidhjet inovatore
- Cilësi e lartë e produkteve dhe shërbimeve

## Rezultatet e siguruara

- Vlera e aksionarit
- Objektiva të qarta
- Standarde të larta
- Fokusi i performancës

## Përmirësim i vazhdueshëm

- Përqendrimi në inovacion
- Gatishmëria për të ndryshuar
- Ngritja e sfidave
- Bashkëpunimi në ekip

## Zhvillimi i qëndrueshëm

- Siguria në plan të parë
- Zbutja e ndryshimeve klimatike
- Performancë e qëndrueshme mjedisore
- Angazhimi i palëve të interesit dhe CSR

# VLERAT TONA THELBËSORE

Vlerat tona qëndrojnë në themel të asaj që përfaqësojmë; ato udhëheqin strategjinë dhe ofrojnë bazën për të gjitha operacionet tona. Sistemi i vlerave tona u ka mundësuar njerëzve tanë një lidhje të fortë dhe kanë udhëhequr rritjen e qëndrueshme për më shumë se një shekull, që buron drejtpërdrejt nga parimet, besimet dhe vizioni i themeluesve tanë në vitin 1902. Ato mbeten baza solide e kulturës dhe shpirtit të familjes tonë. Ato udhëheqin strategjinë tonë, i japin formë vendimeve tona dhe ofrojnë një lidhje të fortë për njerëzit tanë.

# STRATEGJIA E GRUPIT TITAN:

Rritja e biznesit tonë, përqendrimi te klientët, zhvillimi i talenteve tona

Qëllimi i strategjisë së fokusuar te klientët e TITAN-it është të përshpejtojë rritjen e Grupit në tregjet e tij ekzistuese dhe në zona të reja, dhe të ofrojë materiale ndërtimi dhe zgjidhje novatore ndërtimi të nevojshme për një botë më të qëndrueshme, duke përfituar kështu klientët, punonjësit, furnitorët tanë dhe komunitetet.

Strategjia e TITAN e orientuar drejt rritjes bazohet në talentin, aftësitë, kulturën, organizimin dhe mbështetjet në tri shtyllat themelore "dekarbonizim-dixhitalizim-produkt" për të transformuar Grupin në mënyrë që të mund të përdorë burime të reja rritjeje.

## Dekarbonizimi

Ne kërkojmë të rritemi duke transformuar biznesin tonë, duke u fokusuar në elasticitetin dhe inovacionin për t'u shërbyer klientëve tanë në mënyrë sa më efikase ndërsa shkojmë drejt një bote neutrale ndaj karbonit. Strategjia jonë e dekarbonizimit përfshin një grup gjithëpërfshirës mjetesh për të reduktuar shkarkimet e prodhimit të çimentos, duke ofruar produkte të reja novatore për klientët tanë që do të plotësojnë nevojat e tyre për materiale ndërtimi të forta dhe të qëndrueshme, duke shfrytëzuar pasuritë dhe kompetencat unike të Grupit.

## Dixhitalizimi

Ne kemi qenë ndër të parët në sektorin tonë që me anë të operacioneve tona kemi vënë në zbatim zgjidhjet novatore dixhitale të Inteligjencës Artificiale (AI). Tashmë janë zbatuar risi të rëndësishme, me ndikim të matshëm në eficiencën operacionale. Duke pasur parasysh këtë momentum, ne synojmë të vijojmë të përmirësojmë performancën tonë të funksionimit duke përmirësuar përvojën e klientit, me anën e maksimizimit të shpejtësisë së volumit të të dhënave dhe AI për të zhvilluar një model operimi të fuqishëm dhe eficient në mënyrë dixhitale, për të ofruar zgjidhje optimale për klientët tanë, për të zvogëluar hyrjet e prodhimit dhe konsumin e energjisë, dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub>.

## Produkti

Ne synojmë të shfrytëzojmë rekordin tonë të vazhdueshëm të përmirësimit të performancës për të ofruar përsosmëri operacionale në prodhim, zinxhirin e furnizimit dhe përvojën e klientit. Ne do të vijojmë të fokusohemi në koston e prodhimit dhe koston e shërbimit, si dhe në ofrimin e zgjidhjeve dhe një përvojë superiore të klientit në të gjitha bizneset tona.

Grupi po nis tre iniciativa strategjike për të përforcuar zbatimin e strategjisë së TITAN dhe për të përshpejtuar rritjen e tij dhe rrugën e transformimit me përqendrim te klientët.

### 1. Rritja e biznesit tonë


Shfrytëzimi i përsosmërinë operacionale, performanca e veçantë ESG dhe angazhimi më i lartë ndaj klientit, së bashku me dekarbonizimin dhe dixhitalizimin, bëjnë që TITAN do të vazhdojë të zhvillojë platformën e tij të rritjes, duke përfituar nga mundësitë për të forcuar dhe zgjeruar aktivitetet bazë të çimentos dhe betonit me karbon të ulët, si dhe për të ndjekur mundësitë e afërta dhe burimet e reja të vlerave në zinxhirin e vlerës së materialeve të ndërtimit. Grupi do të rrisë biznesin në të gjitha drejtimet për të rritur të ardhurat, por edhe fuqinë e përgjithshme financiare të Grupit, duke përmirësuar performancën e marzhit dhe konvertimin e fluksit të lirë të parasë, duke rritur efikasitetin e shpërndarjes së kapitalit dhe duke optimizuar kapitalin qarkullues. Për këtë qëllim, po zhvillohen mundësitë e synuara për secilin treg lidhur me disa rrjedha pune strategjike që udhëhiqen nga Grupi.

### 2. Përqendrimi te klientët

Grupi TITAN i ka shërbyer gjithmonë klientëve të tij me produkte dhe zgjidhje të cilësisë së lartë. Për të rritur më tej vlerën e ofruar kundrejt klientëve të tij, TITAN po rrit transformimin e tij tregtar i cili, së bashku me dixhitalizimin, dekarbonizimin dhe përsosmërinë operacionale, do t'i lejojë Grupit të adresojë nevojat në zhvillim të klientëve në çdo treg dhe segment, dhe të ofrojë materiale dhe zgjidhje më novatore, të dekarbonizuara dhe me kosto efektive. TITAN do të bashkëpunojë ngushtë me klientët e tij për të ofruar këshilla nga ekspertët dhe zgjidhje të personalizuar, duke ndjekur një qasje të orientuar nga tregu. Për të arritur këtë model operimi të përqendruar te klienti, Grupi do të bëjë investime për të rritur përsosmërinë dhe ekspertizën e forcës së shitjeve në të gjitha segmentet e ndërtimit, të zhvillojë zgjidhje dixhitale që lehtësojnë ndërveprimin me klientët dhe të fillojë një portofol produktesh novatore, të gjelbra dhe plotësuese.


### 3. Zhvillimi i talentit tonë

Tradita e gjatë e TITAN për ndërtimin e aftësive dhe zhvillimin e talenteve me një mentalitet ambicioz, sipërmarrës dhe një kulturë të drejtuar nga vlerat qëndron në themelin e planit tonë strategjik të orientuar drejt rritjes. Plani strategjik përfshin dhe fuqizohet nga një përpjekje e përshpejtuar për të transformuar Grupin duke ndërtuar më tej talentin tonë, si në aspektin e kompetencave bazë ashtu edhe në aspektin e aftësive të reja në udhëheqje dhe praktika menaxheriale. Grupi do të fuqizojë organizimin e tij të vogël dhe të shpejtë në të gjithë gjurmën e tij, ku ekipet me performancë të lartë bashkëpunojnë pa probleme dhe janë të fuqizuara për të marrë vendime dhe për t'u përgjigjur në mënyrë përshtatshme një bote në ndryshim.




# Prania globale e Grupit TITAN

Grupi TITAN raporton performancën dhe aktivitetet bazuar në SHBA, Europën Juglindore, Mesdheun Lindor, Greqi & Europën Perëndimore dhe veçmas në sipërmarrjen e përbashkët në Brazil.



## PROMOVIMI DHE NDARJA E VLERAVE


# 1



### Kapitali financiar

Ne përdorim burimet tona ekonomike në mënyrë efikase për të mbështetur rritjen e biznesit dhe për të siguruar konkurrencën ndërkombëtare.

# 2



### Kapitali intelektual

Ne përdorim aftësitë tona për kërkim dhe zhvillim, kompetencat tona kryesore dhe njohuritë për industrinë e materialeve të ndërtimit për të përmirësuar më tej kontributet dhe performancën tonë.

# 3



### Kapitali social dhe i marrëdhënieve

Ne angazhohemi me palët tona të interesit, duke ndërtuar marrëdhënie afatgjata besimi dhe duke punuar së bashku në projekte bashkëpunuese për të ndikuar pozitivisht në shoqëri dhe komunitetet lokale.

# 4



### Kapitali natyror

Ne sigurojmë materialet me përgjegjësi dhe ruajmë burimet natyrore dhe biodiversitetin në zonat ku operojmë. Kontribuojmë në ekonominë qarkulluese duke zbatuar parimet e "reduktimit, ripërdorimit, riciklimit, rikuperimit".

# 5



### Kapitali njerëzor

Ne vlerësojmë kontributin e njerëzve tanë dhe mbështesim vazhdimisht zhvillimin e tyre profesional në një mjedis pune tërheqës, gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues.

# 6



### Kapitali i prodhimit

Ne prodhojmë produktet tona, duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme në fabrikën e çimentos dhe i shpërndajmë ato në mënyrë të besueshme të klientët tanë përmes terminaleve të dedikuara.

Në thelb, ne besojmë se përdorimi i burimeve tona kapitale në mënyrë eficiente është çelësi për të nxitur krijimin e vlerave të përbashkëta të qëndrueshme dhe afatgjata nëpërmjet produkteve dhe shërbimeve tona. Ne ndihmojmë në adresimin e sfidave ndërkombëtare shoqërore dhe mjedisore dhe kontribuojmë në arritjen e OZHQ-ve të OKB 2030. Duke përdorur burimet dhe ekspertizën tonë, ne përpiqemi të krijojmë ndikim pozitiv dhe të bëjmë një ndryshim domethënës në botë, për brezat që vijnë.



# TË PUNOJMË SË BASHKU PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Grupi TITAN është një pjesëmarrës aktiv në nismat globale të bashkëpunimit dhe organizatat ndërkombëtare, që synojnë të kontribuojnë në formësimin e një bote të qëndrueshme të së nesërme.

## TITAN Group participations

- Pakti Global i OKB (UNGC)
- Nisma e Objektivave të Bazuara në Shkencë (SBTi)
- "Ambicia e biznesit për 1.5°C"
- "Ne kemi parasysh koalicionin e biznesit"
- Fushata globale "Gara drejt Zeros".
- Shoqata Globale e Çimentos dhe Betonit (GCCA)
- CSR Evropë
- ERT (Tryeza e Rrumbullakët Evropiane)\ Grupi i Punës për Tranzicionin e Energjisë dhe Ndryshimet Klimatike
- Akademia Evropiane e Kërkimit të Çimentos (ECRA)



BUSINESS AMBITION FOR 1.5°C

WE MEAN BUSINESS

RACE TO ZERO

gcc  
ca



ERT

ecra



### **Ndërtesa "Tirana Garden"**

Vendndodhja në Rrugën e Kavajës me një sipërfaqe ndërtimi prej 51,090 m<sup>2</sup>.



### **Rezidenca "Lake View"**

Vendndodhja në parkun kryesor të Tiranës, me një sipërfaqe ndërtimi prej 129,000 m<sup>2</sup>.



### **Tuneli i Rrugës së Arbërit**

Tuneli i dytë i këtij segmenti me një gjatësi afërsisht 2 km.



### **Rruga e Arbërit, Ura Vashës**

(Një nga urat më panoramike të këtij segmenti).

**PRODHOJMË  
ÇIMENTO,  
OFROJMË  
FUQI!**

# RRETH ANTEA CEMENT

Fabrika e çimentos ANTEA është një nga investimet më të mëdha direkte në Shqipëri, me standardet më të larta të zbatueshme në drejtim të ndërtimit dhe funksionimit në vend me një vlerë totale që tejkalon shumë prej 200 milionë euro. Fabrika i shërben kryesisht kërkesave të tregut vendas dhe eksporteve në tregje të tjera në rajon.

Që në fazat fillestare të funksionimit, ANTEA ka zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për të adresuar dhe përmirësuar të gjitha çështjet e qëndrueshmërisë që janë materiale për biznesin, por edhe për palët e interesit. Ndër të tjera, ne kemi ndërtuar sisteme të përshtatshme për të siguruar menaxhimin dhe eficientën e energjisë, ndërsa zbatimi i një qasjeje të integruar për menaxhimin e mjedisit ka çuar në arritjen e praktikave më të mira të industrisë në aspekte të ndryshme, si për shembull pasurimi i biodiversitetit, teknologjitë

e reja mjedisore për kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër, zhurmat dhe ndikimet e tjera specifike.

ANTEA investon dhe përdor teknologjinë më të fundit, me mullinj bluarës vertikal, të cilët zënë më pak hapësirë dhe mund të sigurojnë performancë më të mirë mjedisore dhe eficiencë më të lartë në konsumin e energjisë elektrike. ANTEA përdor gjithashtu filtra me qese, të cilat, pavarësisht kostos më të lartë të funksionimit, mund të garantojnë performancë të përmirësuar mjedisore.

Ne po përshejtojmë përpjekjet tona për të promovuar qëndrueshmërinë në të gjithë zinxhirin tonë të vlerës, duke mbështetur njerëzit tanë të rriten brenda një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të sigurt dhe duke nxitur bashkëpunime për të adresuar nevojat e komunitetit lokal.

## Produktet tona

### **CEM I /42.5R:**

*Çimento Portland me përbërës kryesorë 95-100% Klinker dhe përbërës të tjerë të vegjël 0-5%*

### **CEM II /A-LL 42.5R:**

*Çimento Gëlqerore Portland me përbërës kryesorë 80-94% Klinker, 6-20% Gëlqerore dhe përbërës të vegjël shtesë 0-5%*

### **CEM II /B-LL 42,5R:**


*Çimento gëlqerore Portland me përbërës kryesorë 65-79% Klinker, 21-35% Gëlqerore dhe përbërës të vegjël shtesë 0-5%*

### **CEM II /B-LL 32.5R:**

*Çimento gëlqerore Portland me përbërës kryesorë 65-79% Klinker, 21-35% Gëlqerore dhe përbërës të vegjël shtesë 0-5%*

# HISTORIKU I ANTEA

Rrugëtimi jonë drejt zhvillimit që nga 2006



**2017**

- Nisja e projektit "Të mësosh njohuri kompjuterike" Ricertifikimi i sistemeve të menaxhimit
- Vlerësimi i materialitetit

**2018**

- Çmimi H&S "Çmimi për iniciativat më të mira dhe përmirësim të vazhdueshëm 2018" në të gjithë Grupin
- Çmimi i Filantropisë për kontributin e dhënë në nivel lokal në Shqipëri
- Rikonstruksioni i urës "Droja" në Fushë Mamurras

**2019** Politika e re e sinjalizimit u finalizua bazuar në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

**2020**

- Cikli i ri i Procesit të Vlerësimit të Materialitetit
- Platforma e raportimit EthicsPoint e Grupit TITAN
- Programi i Asistencës së Punonjësve TITAN

**2021**

- ANTEA vendosi një rekord të ri shitjesh, duke kaluar shifrën prej 1 milion tonë!
- Fituese e Konkursit të Fotografisë në Revistën Globale të Çimentos
- Objektivat e qëndrueshmërisë të vendosura pas rezultateve të reja të vlerësimit të materialitetit

**2022**

- U vlerësua me Comfortable Green Recognition nga Auditimi i Grupit për SHS.
- Shënoi 365 ditë pa asnjë LTI (Koha e Humbur nga Dëmtimi) ndërmjet punonjësve direkt më 16 shkurt 2022
- Përfundoi me sukses procesin e Vërtetimit të Vlerësimit të Materialitetit

## Anëtarësimet dhe shoqatat e ANTEA:

- Anëtare dhe bashkëthemeluese e Rrjetit Shqiptar të CSR
- Anëtare e Shoqatës së Investimeve të Huaja në Shqipëri (FIAA)
- Anëtare e Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri (AmChAM)
- Anëtare e Shoqatës Helenike të Biznesit në Shqipëri HBAA
- Anëtare e Shoqatës së Prodhuesve Shqiptarë
- Anëtare e Dhomës Italiane të Tregtisë në Shqipëri (CCIA)





# PIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS SË ANTEA

## Përparimi i TITAN drejt objektivave të ESG

Angazhimi ynë për përmirësimin e vazhdueshëm në lidhje me Ndikimet Lokale dhe angazhimi ynë i vazhdueshëm me palët tona kryesore të interesit me iniciativa dhe veprime specifike, të cilat synojnë forcimin e Qëndrueshmërisë së Komuniteteve Lokale, janë elementë thelbësorë të Strategjisë sonë të Biznesit. Në këtë kuadër, **ANTEA** ka kontribuar pozitivisht në arritjen e objektivave përkatës të qëndrueshmërisë së Grupit TITAN për vitin 2025 e më tej. Me përparim të prekshëm në të gjitha zonat e fokusit, ne jemi në rrugën e duhur për të kontribuar në arritjen e objektivave të Grupit ESG për vitin 2025 dhe më tej.

## De-karbonizimi dhe Dixhitalizimi

Ne në ANTEA jemi të fokusuar në qëndrueshmëri, inovacion dhe gjetjen e zgjidhjeve për ndërtimin, për t'u shërbyer klientëve tanë në mënyrë më eficiente ndërsa shkojmë drejt një bote dixhitale neutrale ndaj karbonit. Pas caktimit të Grupit TITAN si nënshkrues i angazhimit "Ambicia e Biznesit për 1.5°C", një fushatë mbarë botërore e udhëhequr nga nisma e objektivave të bazuara në shkencë (SBTi), ne jemi të vendosur të kontribuojmë në kufizimin e ngrohjes globale në 1.5°C dhe të arrijmë zero shkarkime neto deri në vitin 2050. Duke rritur përdorimin e lëndëve djegëse alternative, duke përshpejtuar përpjekjet në efikasitetin e energjisë, duke zhvilluar produkte me nivel të ulët karboni dhe duke adoptuar teknologji dhe zgjidhje novatore, kemi përmirësuar më tej performancën tonë për të përmbushur objektivat ESG që kemi vendosur për vitin 2025 dhe më tej.

Grupi TITAN ka punuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike dhe mundësitë nga kalimi në një

ekonomi me nivel të ulët karboni, në përputhje me Kuadrin e TCFD, që dëshmon transparencë dhe veprime për të zbutur ndryshimet klimatike dhe kalimin në një ekonomi të balancuar të shkarkimeve me një rezultat "A".

Grupi TITAN mbështet dixhitalizimin përmes përpjekjeve të brendshme dhe të jashtme për përmirësimin e aftësive dhe për krijimin e një ekosistemi me partnerë që përfshin biznese fillestare, institucione akademike, prodhues për pajisje dhe sisteme dhe këshilltarë të specializuar. Në fushën përkatëse të dixhitalizimit, ne shohim të dhëna të mëdha, analitika dhe inteligjencë artificiale (AI) të Industry 4.0 si një mundësi për të transformuar industrinë. Për të përmirësuar përvojën e klientit dhe për të krijuar një model operimi tregtar më eficient, ne kemi punuar në **dixhitalizimin e mënyrës se si ndërveprojmë me klientët tanë**, duke vendosur aplikacione dixhitale për klientët.

Në fushën e prodhimit, Qendra Dixhitale e Kompetencës së Grupit vazhdoi paraqitjen e zgjidhjeve ekzistuese të Optimizuesit në kohë reale bazuar në inteligjencën artificiale për linjat e saj të prodhimit të çimentos dhe zhvilloi linja të reja. Optimizuesit në kohë reale, të cilët burojnë të dy nga partnerë të jashtëm, si dhe të zhvilluar brenda në shoqëri, **mundësojnë rritjen e prodhimit për çdo pajisje prodhuese**.

ANTEA ka investuar në dixhitalizimin e operacioneve të saj për të konkurruar me sukses në modelin e ri të operimit që teknologjia po sjell në industrinë e materialeve të ndërtimit.

Përveç kësaj, ANTEA ka zbatuar dhe mirëmban një zgjidhje optimale për drejtimin e menaxhimit të kamionëve dalës, e cila ndihmon në përmirësimin e performancës duke ofruar të dhëna në kohë reale.

## Qëndrueshmëria e infrastrukturës së IT dhe sulmeve kibernetike

ANTEA ka zbatuar sisteme dhe mekanizma sigurie **për të mbrojtur më mirë infrastrukturën dhe të dhënat e saj nga sulmet kibernetike**.

ANTEA operon bazuar në kuadrin e Sigurisë së Informacionit dhe politikave të TITAN dhe në përputhje me menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut në lidhje me IT, të cilat janë të gjitha në linjë me politikat dhe procedurat e Grupit IT.

ANTEA ofron trajnime interaktive për punonjësit e saj në baza vjetore, për të informuar më mirë të gjithë përdoruesit përfundimtarë, duke ulur rreziqet duke rritur aftësitë ekzistuese të parandalimit proaktiv dhe duke krijuar aftësi të reja për zbulimin dhe reagimin e shpejtë.

Për të forcuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike ndaj sulmeve kibernetike, ne po zbatojmë vazhdimisht praktikat më të mira dhe po përmirësojmë planet tona të vazhdimësisë së biznesit.

Për më tepër, ANTEA ka filluar tashmë përgatitjet për zbatimin e sistemit të përbashkët ERP të Grupit.

## Ambient pune që mundëson zhvillim

Promovimi i një **kulture gjithëpërfshirëse me mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit tanë** për t'u përmirësuar profesionalisht në një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm është çelësi i misionit tonë.

Ne forcuar sistematikisht sistemet tona të parandalimit të aksidenteve dhe promovimit të shëndetit, të udhëhequr nga politika jonë e Grupit për Shëndetin dhe Sigurinë. ANTEA ka qenë pjesë e Çmimit për Shëndetin dhe Sigurinë e Rajonit TITAN i nisur në vitin 2022 me iniciativa për të inkurajuar dhe përmirësuar vazhdimisht shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Në vitin 2022, **Shpeshësia e Kohës së Humbur nga Dëmtimi (LTIFR) për punonjësit direkt ishte 0.0**, për punonjësit indirekt ishte 2.0 dhe për punonjësit direkt dhe indirekt ishte 1.2 LTI në orë një milion orë pune.

## Punonjësit tanë janë në qendër të biznesit tonë,

dhe ne po zbatojmë vazhdimisht iniciativa që adresojnë dimensionet fizike, mendore, sociale dhe financiare të mirëqenies së tyre, si pjesë e angazhimit tonë të vitit 2025 për të kultivuar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm. ANTEA ka qenë pjesë e fushatës së shëndetit mendor të Grupit TITAN të nisur në tetor 2021 me iniciativa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe inkurajimin e shëndetit të mirë mendor. Fushata konsistoi në paraqitjen e materialeve të dobishme, të tilla si artikuj, video dhe pyetësorë të vetë vlerësimit, dhe promovimin e shërbimit të mbështetjes së konsulencës së Grupit TITAN, TITAN EAP (Programi i Ndihmës për Punonjësit).

Tre shtyllat e strategjisë së TITAN për punonjësit janë **mësimi, talenti dhe organizimi**, të cilat mbështeten nga një themel i një mjedisi pune angazhues dhe gjithëpërfshirës që është i drejtë dhe transparent. Menaxhimi i shpërblimeve, menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore, programet e përmirësimit dhe rikualifikimit, si dhe përmirësimi i aftësive drejtuese, funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë, dekarbonizimi dhe aftësitë digjitale, inkurajohen të gjitha nga rëndësia e të mësuarit. Akademia e Leadershipit ANTEA u rihap në vitin 2021. Ne do të ofrojmë mundësi për përmirësim dhe rikualifikim për të gjithë punonjësit tanë, veçanërisht në zona kritike për përmirësim afatgjatë, si shëndeti dhe siguria, digjitalizimi dhe dekarbonizimi.

ANTEA synon të rrisë vazhdimisht numrin e grave në grupet e talenteve dhe punësimet e reja deri në vitin 2025.

## Ndikim pozitiv lokal

Kontributi i operacioneve tona të biznesit sikurse dhe vemendja e njerëzve tanë në mbarë botën me qëllim sigurimin e mirëqenies në komunitetet tona lokale në lidhje me shqetësimet e tyre sociale dhe mjedisore është një shtyllë kryesore e objektivave tona ESG. Në ANTEA, **sistemet e menaxhimit monitorojnë dhe raportojnë për reduktimin e shkarkimeve në ajër, mbrojtjen**

**e biodiversitetit, menaxhimit dhe riciklimin e ujit dhe rehabilitimin e gurorëve.** Për më tepër, përqindja e sipërfaqeve të tokës gurore të rehabilituara nga totali i tokës së prekur është rritur në krahasim me vitin e kaluar. **Planet tona të angazhimit të komunitetit u përfruan me çështjet materiale për palët tona të interesit dhe OZHQ-të e OKB 2030.**

## Burimet e përgjegjshme

ANTEA është e përkushtuar ndaj parimeve të ekonomisë qarkulluese, duke ndërmarrë veprime për të minimizuar, ripërdorur, ricikluar ose rikuperuar materialet dhe energjinë për të ruajtur burimet natyrore, për të reduktuar shkarkimet e CO<sub>2</sub> dhe për të menaxhuar mbetjet në mënyrë eficiente. Duke e njohur ekonominë qarkulluese si themelore për zhvillimin e një modeli biznesi më të qëndrueshëm, shoqëria përshtat dhe zbaton sistematikisht praktika të mira për të minimizuar gjurmën e saj dhe **për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.**

## Pritshmëritë ndaj bazës sonë të furnitorëve

Ne vendosim të njëjtat kërkesa për furnitorët dhe partnerët tanë të biznesit në mbarë botën. Ne presim që ata të sillen në një mënyrë të besueshme me kërkesat tona të qëndrueshmërisë. Në përzgjedhjen dhe punën me partnerët/furnizuesit tanë të biznesit, ne konsiderojmë krahas treguesve kryesorë tregtarë dhe operacionalë **performancën e tyre në lidhje me sigurinë, shëndetin, mjedisin, standardet sociale dhe praktikën e drejtë të biznesit** si kritere vendimtare.

## Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit

Nëpërmjet qeverisjes së mirë të korporatës, ne synojmë të sigurojmë që çdo vendim i menaxhimit të jetë në përputhje me qëllimin dhe vlerat tona thelbësore, sipas konsideratave tona të qëndrueshmërisë dhe t'u shërbejë interesave më të mira të palëve tona të interesit.

Duke **identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë proaktive të gjitha rreziqet dhe mundësitë tona potencialisht të rëndësishme**, ne jemi të përgatitur për të arritur objektivat tona strategjike dhe për të adresuar çështjet që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit tonë.

## Qeverisja e qëndrueshmërisë

Qëndrueshmëria është **pjesë e rëndësishme në strategjinë tonë** përmes rishikimit të rregullt të të gjitha çështjeve që janë materiale për biznesin dhe palët tona të interesit, përcaktimit të veprimeve dhe objektivave të duhura dhe respektimit të politikave mjedisore, sociale dhe të qeverisjes.

## Politikat e Grupit dhe Kodi i Sjelljes

Për të siguruar **drejtimin e biznesit me respekt, llogaridhënie dhe përgjegjësi**, Grupi TITAN zhvilloi Kodin e Sjelljes dhe Politikën e Grupit, të cilat mbulojnë të gjitha fushat strategjike dhe ofrojnë udhëzime për punonjësit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të biznesit, për të siguruar përputhjen me rregullat e brendshme dhe statutorë të zbatueshme. Politikën e Grupit përfshijnë, por nuk kufizohen në, Anti-Ryshfetin dhe Korrupsionin, Konfliktin e Interesit, Ligjin e Konkurrencës, Sanksionet, Përgjegjësinë Sociale të Korporatës, Sinjalizimin. Të gjitha politikën tona janë të disponueshme në faqen e internetit të korporatës së Grupit (<https://www.titan-cement.com/about-us/corporate-governance/group> *Shikoni tabelën e Deklaratës ESG 2.5.3 Politikën dhe Kodi i Sjelljes së ESG*

## Programi i Perputhshmërisë së Grupit TITAN dhe etika e biznesit

Një Program i Perputhshmërisë së Grupit TITAN është krijuar që nga viti 2020, si një sistem i integruar aktivitetesh, mekanizmash dhe kontrollesh, që synon të ofrojë sigurinë e duhur që rreziqet e mospërputhshmërisë të identifikohen

në kohë, vlerësohen siç duhet dhe zbuten në mënyrë efektive, në mënyrë që mundësia e një dështimi të konsiderueshëm të minimizohet. Programi i Perputhshmërisë lehtëson përpjekjet për të **ruajtur dhe nxitur një kulturë të fortë**, duke siguruar respektimin e kërkesave të saj dhe duke promovuar sjellje etike të qëndrueshme dhe të përgjegjshme. Është një program i bazuar në rrezik me elemente dinamike dhe përfshin monitorimin dhe mbikëqyrjen, ndërgjegjësimin për perputhshmërinë, trajnimin, vlerësimin e rrezikut dhe komponentët e vigjilencës së duhur nga palët e treta. Në përputhje me vlerat dhe kulturën tonë, dhe siç artikullohet qartë në Kodin e Sjelljes së TITAN dhe Politikën përkatëse të Grupit, Grupi ndjek një qasje me tolerancë **zero ndaj ryshfetit, mashtrimit dhe çdo praktike tjetër korruptive**. Kuadri i Programit kundër Mashtrimit promovon hapjen dhe transparencën, ofron standarde dhe udhëzime dhe qartëson rolet, pritshmëritë dhe përgjegjësitë rreth temës së mashtrimit në punë. Në vitin 2021, TITAN nisi fazën e dytë të programit të tij "Ndërgjegjësimi për Politikën e Grupit", me synimin **për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e Kodit tonë të Sjelljes** dhe grupit të Politikave të Qëndrueshmërisë dhe Përgjegjësisë Sociale – mjetet që **nxisin sjelljen etike** dhe përfaqësojnë "Kulturën tonë në Praktikë".

## Përkushtimi ndaj të drejtave të njeriut

Në përputhje me Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, TITAN është i përkushtuar të respektojë dhe mbështesë të drejtat e njeriut në lidhje me punonjësit e tij, komunitetet ku operon dhe partnerët e tij të biznesit. Të drejtat e njeriut janë një nga fushat kryesore lëndore të Programit të Pajtueshmërisë së Grupit TITAN, i cili ofron **një kuadër të mirë-strukturuar për të trajtuar aktivitetet përkatëse në mënyrë të disiplinuar dhe gjithëpërfshirëse** në të gjithë Grupin. Në mënyrë që të intensifikojmë përpjekjet tona për të siguruar përputhjen jo vetëm me kërkesat rregullatore, por edhe me kërkesat ESG, dhe për të siguruar një zinxhir furnizimi të përgjegjshëm, një sistem gjithëpërfshirës i vigjilencës

së duhur të palëve të treta, i mbështetur nga një mjet në internet, u zhvillua në vitin 2021 dhe është gati të vihet në zbatim. Politika jonë e Sinjalizimit inkurajon punonjësit të raportojnë sjellje të pahijshme, mashtrime ose abuzime të mundshme. Paralelisht, EthicsPoint, platforma e raportimit të Grupit ofron një kanal uniform, anonim dhe rreptësisht konfidencial, nëpërmjet një mjeti dixhital të disponueshëm globalisht, për të lehtësuar raportimin konfidencial të çdo shqetësimi dhe për të siguruar që incidentet raportohen, shqyrtohen dhe zgjidhen me plan korrigjues, nëse dhe kur është e nevojshme, duke nxitur kështu një kulturë integriteti dhe sjelljeje etike.



### Perspektiva 2023

Ne duam të përshpejtojmë rritjen e biznesit tonë dhe të njerëzve tanë, ndërkohë që fokusi ynë mbetet në krijimin e vlerës për klientët përmes inovacionit, dekarbonizimit të shitjeve tona dhe dixhitalizimit më të shpejtë të operacioneve tona. Prioritetin më të lartë do ta ketë siguria brenda dhe rreth operacioneve tona. Siguria nuk duhet konsideruar asnjëherë si e mirëqenë dhe ne jemi të përkushtuar të bëjmë gjithçka që duhet për të përmirësuar performancën tonë në këtë fushë, sidomos në sistemet e sigurisë së kontraktorëve. Bazuar në themelet që kemi vendosur në vitin 2022 me fillimin e politikës së Diversitetit, Barazisë dhe Përfshirjes së Grupit, ne do të përshpejtojmë mënyrat për të çuar përpara një kulturë pune gjithëpërfshirëse që përvetëson dhe manifeston diversitetin.





# RAPORTI MENAXHERIAL

## QEVERISJA E KORPORATËS DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

Qeverisja e Korporatës në shoqërinë tonë përfshin dhe promovon transparencën, llogaridhënien dhe sigurinë, në përputhje me vlerat dhe misionin tonë.

Bordi i ANTEA Cement është i përkushtuar të sigurojë një strukturë të fortë qeverisjeje, duke pranuar se qeverisja e mirë e korporatës është një komponent jetik për të mbështetur menaxhimin në përmbushjen e objektivave strategjike të shoqërisë dhe operimin e një biznesi të qëndrueshëm për të mirën e të gjitha palëve të interesit. ANTEA zbaton procedurat e besueshme të qeverisjes së korporatës, në përputhje me ligjet dhe rregulloret shqiptare në fuqi, si dhe me Kodin e Sjelljes dhe Politikën e Grupit të Titan.

# STRUKTURA ORGANIZATIVE, BORDET DHE KOMITETET E ANTEA CEMENT:



# BORDET DHE KOMITETET DREJTUESE TË ANTEA-S

## Bordi i cilësisë:

Niveli drejtues i Shoqërisë është i përfshirë në Sistemin e Cilësisë përmes Bordit të Cilësisë. Në përgjithësi, Bordi i Cilësisë ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Krijimin e Politikës së Cilësisë së Shoqërisë
- Miratimin e Sistemit të Cilësisë dhe specifikimeve
- Kryerjen e auditimeve të brendshme të cilësisë
- Kryerjen e rishikimeve të Sistemit të Cilësisë
- Vendosjen e objektivave të cilësisë

## Bordi i Mjedisit:

Bordi i Mjedisit është përgjegjës për identifikimin e aspekteve mjedisore, përcaktimin e emergjencave dhe nevojën për përgatitjen e planeve emergjente, rishikimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor në baza vjetore, etj.

## Bordi i Përgjegjësisë Sociale:

Bordi i Përgjegjësisë Sociale është përgjegjës për të identifikuar çështjet e standardit SA8000, për të përcaktuar veprimet e nevojshme parandaluese ose korrigjuese dhe për të rishikuar standardin SA8000 në baza vjetore.

## Komiteti i Konfliktit të Interesit:

Komiteti i Konfliktit të Interesit është përgjegjës për zbatimin e procedurës së Konfliktit të Interesit dhe ofron zgjidhje për të gjitha konfliktet e raportuara ose të identifikuar të interesit.

## Komiteti Shëndetit dhe Sigurisë:

Komiteti i Shëndetit dhe Sigurisë ofron udhëzime strategjike dhe taktike për përmirësimin e iniciativave në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në fabrikën e ANTEA-s.

- U vlerësua me *Comfortable Green Recognition* nga Auditimi i Grupit per SHS
- Shënoi 365 ditë pa asnjë LTI (Koha e Humbur nga Dëmtimi) ndërmjet punonjësve direkt më 16 shkurt 2022
- Përfundoi me sukses procesin e Vërtetimit të Vlerësimit të Materialitetit

Ky Komitet krijon procese efektive për biznesin, për të promovuar zbatimin e plotë të Politikës së Grupit TITAN mbi Shëndetin dhe Sigurinë.

## Komiteti i Kontrollit të Kredisë:

Ky Komitet është përgjegjës për arkëtimet dhe detyrimet nga Klientët dhe detyrat e tij kryesore përfshijnë:

- Vlerësimin dhe miratimin e kredisë
- Formularët e vlerësimit të klientit/vlerësimin e klientit
- Shlyerjen e borxheve të klientëve
- Mbulimin e borxhit I Garancitë
- Monitorimin dhe kontrollin e kredisë
- Përcaktimin e provizioneve të lidhura me rrezikun e kredisë

## Komiteti CSR:

Detyra kryesore e Komitetit të CSR është përgatitja dhe zbatimi i Planit të Veprimit të CSR, i cili pasqyron çështjet materiale të shoqërisë dhe menaxhimit e duhur të tyre. Komiteti CSR kryen gjithashtu detyrat e mëposhtme:

- Propozimin, hartimin dhe miratimin e politikave dhe procedurave të CSR

- Vlerësimin dhe vendosjen për Projektet CSR
- Përgatitjen e Raportit Vjetor të Integruar
- Përgatitjen e publikimeve të tjera si fletëpalosje, buletinet etj.
- Angazhimin me komunitetin lokal përmes mekanizmit të ankesave
- Zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për Angazhimin e Komunitetit

## Shumëllojshmëria dhe Përfshirja

Në ANTEA jemi të fokusuar në përfshirjen dhe në krijimin e një ambienti pune që maksimizon potencialin e të gjithë punonjësve. ANTEA është e përkushtuar të ofrojë mundësi të barabarta dhe inkurajon shumëllojshmërinë dhe përfshirjen në çdo nivel punësimi në shoqëri. Shumëllojshmëria përfshin gjininë, moshën, kombësinë, aftësinë e kufizuar, origjinën etnike, orientimin seksual, kulturën, arsimin dhe formimin profesional. Në nivel Grupi, vëmendje e veçantë i kushtohet monitorimit të zbatimit të Politikës së të Drejtave të Njeriut, një pjesë e së cilës i referohet promovimit të shumëllojshmërisë dhe sigurimit të përmirësimit të vazhdueshëm të shumëllojshmërisë në të gjithë organizatën. Përmirësimi i përzierjes gjinore në të gjitha nivelet është gjithmonë një zonë fokusi.



# AUDITIMET E ANTEA-S DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

## Auditimet e ANTEA-s

ANTEA monitoron të gjitha çështjet materiale të identifikuar dhe me përparësi si në grup ashtu edhe në nivel lokal. Ndër të tjera, çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe lirinë e organizimit, janë vetëm disa nga çështjet që monitorohen nga afër dhe raportohen në detaje në seksionin e Deklaratave të Performancës ESG të këtij Raporti. Auditorët e pavarur testojnë dhe vlerësojnë zbatimin e sistemeve dhe procedurave përkatëse të menaxhimit çdo vit, ndërsa regjistrojnë zonat për përmirësime të mëtejshme.

Auditimi i brendshëm është gjithashtu një proces i standardizuar i mbuluar si nga ekspertët e Grupit ashtu edhe nga ekspertët vendorë për çështje specifike, për shembull në lidhje me shëndetin ose sigurinë në punë, menaxhimin e mjedisit, menaxhimin e energjisë. Për Shëndetin dhe Sigurinë, Departamenti i Performancës së Grupit ESG është përgjegjës për zbatimin e auditimeve të brendshme si çdo vit ashtu edhe në periudha të zgjatura 3-vjeçare për të gjitha aspektet përkatëse të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit.

Auditimi vjetor i Grupit të Shëndetit dhe Sigurisë përfshin të gjithë funksionimin e fabrikës dhe kontraktorët e përhershëm gjithashtu. Fokusi është të sigurohet saktësia e procedurave H&S, integriteti i pajisjeve, projektet e reja etj.

- **Comfortable Green Recognition nga Auditimi i Grupit per SHS.**
- **Vazhdimi i certifikatës ISO 45001:2018 (OHSAS)**

Pas planit të veprimit të H&S, inspektimi i brendshëm dhe auditimet u fokusuan në:

Procedurat e izolimit të burimeve të energjisë Lototo, proceset e shmangura të hetimit, aktivitetet e shpërthimit, hapësirat e kufizuara, intervista e punonjësve në lidhje me njohuritë

e tyre, procedurat e bluarjes së karburantit të ngurtë, gatishmëria për emergjenca si stërvitjet për shuarjen e zjarrit, mjetet e transportit, ndërrimi i turneve, aplikimi për lejet e punës në kantier.

ANTEA Cement është certifikuar sipas ISO 45001:2018 deri në korrik 2021 dhe tashmë ka përshtatur të gjitha Procedurat e Shëndetit dhe Sigurisë me Standardin e ri.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme për auditimet, në nivel vendi, Autoritetet Kompetente bëjnë kontrolle të rregullta ku nuk ka mospërputhje apo gjoha lidhur me mospërputhshmërinë e operacioneve të ANTEA me Inspektoratin e Punës, mjedisin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, shfrytëzimin e minierave nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencën në Miniera, lidhur me aktivitetet minerare ose ligjet e konkurrencës. Autoritetet e Shëndetit Publik Vendor kryejnë një inspektim vjetor duke monitoruar pajtueshmërinë ligjore në lidhje me legjislacionin shëndetësor. Përveç kësaj, inspektori lokal i zjarrfikësve kryen një inspektim vjetor për të siguruar që të gjitha mjetet zjarrfikëse të ANTEA janë plotësisht funksionale.

Përveç inspektimeve të autoriteteve, auditimet periodike kryhen brenda vendit nga Zyra Qendrore e Grupit TITAN. Në lidhje me SH&S janë kryer katër (5) auditime nga Drejtori i Grupit për Shëndetin në Punë, Sigurinë dhe Mjedisin dhe Drejtori Rajonal i H&S SEE & Turqi. Në total, 132 veprime u propozuan për përmirësim, duke përfshirë sistemin e menaxhimit të H&S, pajisjet e fabrikës dhe funksionimin e fabrikës. Kontrollat periodike kryhen nga palë të treta dhe ANTEA Cement rezultoi në përputhje me kërkesat standarde.

Takimet e Komitetit të SH&S dhe SH&S të fabrikës u mbajtën rregullisht, për të monitoruar çështjet e SH&S, për të planifikuar dhe koordinuar veprimet e nevojshme veçanërisht në lidhje me COVID-19. Rezultatet e pritshme janë arritur duke përbushur 90% të objektivave të Shëndetit dhe Sigurisë 2022.

Lidhur me Standardin e Përgjegjësive Sociale SA8000:2014, ANTEA auditohet dy herë në vit

nga një auditor i pavarur (Eurocert) duke siguruar zbatimin korrekt të të Drejtave të Njeriut.

## Menaxhimi i Rrezikut

Bordi Drejtues është përgjegjës për të mbikëqyrur rezultatet e një procesi sistematik të vlerësimit të rrezikut që mbulon rreziqet dhe mundësitë financiare, sociale dhe mjedisore. Rreziqet identifikohen dhe adresohen çdo ditë në nivele të ndryshme në organizatë, sipas natyrës të secilit rrezik.

Qasja e ANTEA për Menaxhimin e Rrezikut fokusohet në identifikimin e rreziqeve dhe përdorimin e praktikave të menaxhimit që do të trajtojnë në mënyrë efektive rrezikun dhe do të sigurojnë përafrimin e politikave, praktikave dhe sistemeve të menaxhimit në të gjithë Grupin. Bordi ka përgjegjësinë e përgjithshme për të përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve kryesore që Shoqëria është e gatshme të marrë përsipër në arritjen e objektivave strategjike të Grupit, ndërsa përgjegjësia për të monitoruar efektivitetin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm të ANTEA i delegohet nga Bordi Komitetit të Auditimit dhe Rrezikut.

Politikat tona, sistemet e menaxhimit dhe masat për adresimin dhe kontrollin e duhur të rreziqeve, ndër të tjera përfshijnë:

- **Auditim të brendshëm dhe të sistemeve në përputhje me kërkesat aktuale të sistemeve të menaxhimit**
- **Trajnim për Kodin e Sjelljes për zbatimin e masave anti-korrupsion**
- **Krijimin e komiteteve të ndryshme në shoqëri për adresimin e sfidave dhe çështjeve të ndryshme**
- **Mirëmbajtjen e komunikimit me punonjësit dhe palët e tjera të interesit**
- **Kryerjen, lehtësimin dhe monitorimin e angazhimit me komunitetin lokal**

Që nga dhjetori i vitit 2018, ANTEA vepron plotësisht në përputhje me "Rregulloren e re të Unifikuar për procedurën e hetimit administrativ për sinjalizimin, mbrojtjen e konfidencialitetit, mbrojtjen e të

dhënave personale dhe mbrojtjen nga hakmarrja" në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Në vitin 2019, një politikë e re e Grupit për sinjalizimin u finalizua dhe u zbatua nga ANTEA për të mbrojtur hyrjen në mekanizmat e pavarur dhe të sigurt të raportimit anonim të incidenteve për hetime të mëtejshme.

### Mekanizmat e ankesave dhe ankesat nga palët e jashtme të interesit

Që nga fillimi i funksionimit të saj, ANTEA kishte në funksion një mekanizëm ankesash për punonjësit e saj, duke vënë në dispozicion jo vetëm për punonjësit tanë një mekanizëm të sigurt për të raportuar shqetësimet dhe ankesat. Në fillim të vitit 2020, u lançua një platformë në të gjithë Grupin (Pika Etike) për të lehtësuar aksesin e të gjithë punonjësve tanë në mekanizmin e ri të Ankesave që funksionon në nivel Grupi.

ANTEA ka zhvilluar një procedurë në lidhje me ankesat nga **palët e jashtme të interesit**. Banka e të dhënave CSR e Grupit TITAN, një sistem për mbledhjen e të dhënave, përdoret rregullisht për të regjistruar dhe raportuar çdo vit për të gjitha Njësitë e Biznesit ankesat e ndryshme të ngritura nga palët e interesit në nivel vendor, qoftë nga individë, qoftë nga përfaqësues të komunitetit, OJQ apo të tjerë.

Dialogu konstruktiv i vazhdueshëm me palët e interesit të ANTEA, në të gjitha nivelet - nivel kombëtar dhe lokal - mundëson zbatimin e strategjisë sonë afatgjatë të qëndrueshmërisë dhe fuqizon bashkëpunimin për çështjet materiale të trajtuara nga palët e interesit.

### Sistemet e Menaxhimit

Që nga fillimi i funksionimit të saj, ANTEA ka zhvilluar dhe zbatuar sisteme të menaxhimit të integruar të pavarur të certifikuar. Ato përbëhen nga Sistemi i menaxhimit të cilësisë ISO 9001, ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, ISO 45001:2018 (OHSAS) për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, SA8000:201 për Standardin e Përgjegjësisë

Sociale. SA8000 inkurajon organizatat që të zhvillojnë, mirëmbajnë dhe zbatojnë praktika të pranueshme shoqërore në vendin e punës. Që nga viti 2012, ANTEA ka një sistem të integruar të menaxhimit dhe është certifikuar për:

- **SA8000:2014** Standard është standardi kryesor i certifikimit social për fabrikat dhe organizatat në të gjithë globin. Standarti përfshin dispozitat e punës nga konventat e Deklaratës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Ky standard gjithashtu respekton, plotëson dhe mbështet ligjet kombëtare të punës, duke ndihmuar punonjësit dhe duke siguruar kushte etike të punës. Ne sigurojmë që ANTEA të përmbushë të gjitha kërkesat SA8000:2014 për të menaxhuar marrëdhëniet e punës sipas standardeve ndërkombëtare. ANTEA monitoron dhe ndihmon kontraktorët tanë në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut. Ne kryejmë inspektime për të siguruar që rregullat të cilat ndalojnë punën e fëmijëve ndiqen, me një theks të veçantë në verifikimin e moshës. Gjithashtu, ne hetojmë përputhshmërinë me rregulloret lidhur me punën e detyruar dhe kushtet e punës si orari i punës, shpërblimi dhe kontributi i sigurimit për kontraktorët më të mëdhenj. Nëpërmjet zbatimit të standardit të punës SA8000, shoqëria nxit sindikatat e punonjësve. Standardi lejon përfaqësuesit e punëtorëve që të komunikojnë me nivelet e menaxhimit. Kreu i Sindikatës dhe përfaqësuesit e punonjësve kanë mundësinë të komunikojnë me stafin drejtues për çështje të ndryshme si detyrimet, përmirësimet, çështjet e shëndetit dhe sigurisë dhe çdo temë tjetër që ndikon në kushtet e punës së punonjësve. Një auditor i pavarur auditon ANTEA-n dy herë në vit për të siguruar që standardi i lartpërmendur zbatohet dhe monitorohet në mënyrë korrekte. Ricertifikimi sipas këtij standardi ka ndodhur në dhjetor 2021 dhe është i vlefshëm deri në dhjetor 2023.

- **ISO 9001:2015** Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë synon të ketë si objektivi final zbatimin


e parimeve të cilësisë totale në të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë. Përvoja e klientëve përmes komunikimit efektiv dhe komenteve mbi kërkesat dhe ankesat e tyre është një nga objektivat kryesore të Shoqërisë. Gama e zbatimit të Sistemit të Cilësisë së Shoqërisë shtrihet në të gjithë faktorët që kontribuojnë në veprimtaritë e Shoqërisë (personeli, pajisjet, materialet), duke përfshirë të gjithë furnizuesit e saj, duke synuar krijimin e marrëdhënieve reciproke të dobishme midis tyre dhe Shoqërisë.

- **ISO 14001:2015** për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor që mbulon dhe mbikëqyr të gjitha aspektet mjedisore. Sistemi përfshin shkarkimet në ajër, gurorët, peizazhet, ujërat nëntokësore, pusët dhe mbetjet ujore, mbetjet e lëngshme dhe të ngurta, burimet natyrore dhe konsumin e energjisë, zhurmën, etj. Ne synojmë të promovojmë qëndrime dhe sjellje të përgjegjshme ndaj mjedisit për të gjithë punonjësit dhe të inkurajojmë furnizuesit,

klientët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të biznesit që të përvetësojnë praktika të ngjashme.

- **ISO 45001:2018 (OHSAS)** Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ofron një kuadër për menaxhimin efikas të OH&S, duke përfshirë të gjitha aspektet e menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërisë ligjore. Sistemi trajton shëndetin dhe sigurinë në punë dhe jo ndonjë çështje specifike të sigurisë së produktit.

Sistemet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMS) përmirësojnë performancën e burimeve njerëzore dhe aftësinë për të menaxhuar burimet njerëzore në mënyrë më efikase. Janë propozuar disa module të Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMS) për të dixhitalizuar procese të ndryshme të burimeve njerëzore, duke përfshirë qendrën e punonjësve, menaxhimin e performancës, planifikimin e vazhdimësisë, sistemin e menaxhimit të të mësuarit, modulën e kompensimit, rekrutimin dhe fillimin e punës. Informacioni i marrë nga HRMS është një mjet i dobishëm për përmirësimet e ardhshme të njerëzve dhe vendimet për investimet.





# RISHIKIMI I PERFORMANCËS FINANCIARE

Performanca financiare e ANTEA monitorohet dhe vlerësohet gjatë gjithë vitit. Viti 2022 u karakterizua nga një ecuri e qëndrueshme dhe e besueshme për ANTEA Cement dhe filialet e saj. ANTEA Cement adresoi me sukses sfidat e kërkesës për çimento si në tregun vendas ashtu edhe në atë të eksportit dhe e kapitalizoi rezultatin e saj në këtë kërkesë. Në të njëjtën kohë, ANTEA u fokusua në objektivin e qëndrueshëm të rritjes së ekuilibrit, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, duke përqafuar ndryshimin si organizatë dhe duke prezantuar risi me një ritëm të përsheptuar. Disa nga treguesit kryesorë financiarë janë rishikuar më poshtë, duke krahasuar periudhën aktuale raportuese me periudhën e mëparshme raportuese.

Gjatë vitit 2022, të ardhurat e konsoliduara nga shitja e produkteve janë rritur me 28.34 milion euro ose 38% krahasuar me vitin paraprak. Nga 103.22 milion euro të ardhura të konsoliduara nga shitja e produkteve 74% rrjedhin nga shitjet në tregun e brendshëm dhe 26% nga shitjet në tregjet e eksportit. Tregjet kryesore ku shoqëria po eksporton janë në vendet fqinje dhe në rajonin e Mesdheut. Fitimi operativ i konsoliduar u rrit me 3.24 milion euro ose 25% krahasuar me vitin e kaluar, duke kontribuar kështu në një rritje prej 3.20 mijë euro të EBITDA së konsoliduar krahasuar me vitin e kaluar. Fitimi i konsoliduar para tatimit për vitin arriti në vlerën 15.28 milion euro, që ishte më e lartë se fitimi prej 4.48 milion euro krahasuar me një vit më parë.

Rezultatet e sipërpërmendura të operacionit të shoqëruara me lëvizjen e kapitalit qarkullues të shoqërisë rezultuan në një fluks monetar neto të konsoliduar nga aktivitetet operacionale në vlerën 11.69 milion euro, e cila ishte 6.02 milion euro më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Shoqëria shfrytëzoi këto burime për të investuar në kapitalin e ri në shumën prej 4.80 milion euro dhe ka përdorur fluksin neto të parasë për shlyerjen e huave në shumën prej 10.00 milion euro gjatë kësaj periudhe. Shoqëria e mbylli vitin financiar në një pozicion likuiditeti të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm.

## PASQYRAT FINANCIARE

### PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

(Shumat e shprehura në mijëra ALL përveç nëse deklarohet ndryshe)

Shënimet	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	
Të ardhurat	7	12,280,125	9,174,096
Kostoja e shitjes	8	(9,661,229)	6,975,496
<b>Fitimi bruto</b>		<b>2,618,896</b>	<b>2,198,600</b>
Të ardhura të tjera operative	9	103,473	63,723
Shpenzime të tjera operacionale	10	(48,558)	(25,064)
Shpenzimet e shitjes dhe të marketingut	11	(82,861)	(77,923)
Shpenzime administrative	12	(651,923)	(605,578)
<b>Fitimi operacional</b>		<b>1,939,027</b>	<b>1,553,758</b>
Kostot Financiare	14	(120,758)	(315,968)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>1,818,269</b>	<b>1,237,790</b>
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	15	(328,336)	(158,001)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>1,489,933</b>	<b>1,079,789</b>
<b>TË ARDHURA TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE</b>			
Diferencat valutore nga konvertimi i operacioneve të huaja	31	(14,593)	(4,620)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,475,340</b>	<b>1,075,169</b>
<b>FITIMET NETO QË I ATRIBUOHEN:</b>			
Pronarit të shoqërisë mëmë		1,475,340	1,075,169
Interes jokontrollues		-	-
		<b>1,475,340</b>	<b>1,075,169</b>
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE QË I ATRIBUOHEN:</b>			
Pronarëve të shoqërisë mëmë		1,475,340	1,075,169
Interes jokontrollues		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,475,340</b>	<b>1,075,169</b>

Tabela e mësipërme është nxjerrë nga Pasqyrat Vjetore Financiare të Konsoliduara të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Grupi i plotë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Konsoliduara për vitin 2022, së bashku me raportin e auditorit të pavarur dhe zbulime të tjera informacionesh bashkëngjitur pasqyrave financiare, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" është publikuar në faqen e internetit të shoqërisë (<https://www.anteacement.com/publications/reports-antea/>).

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

(Shumat e shprehura në mijëra ALL përveç nëse deklarohet ndryshe)

Shënimet	më 31 dhjetor 2022	më 31 dhjetor 2021
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive jo afatshkurtra</b>		
Prona, fabrika dhe pajisje	16,022,826	16,368,210
Aktivet jo-materiale	24,191	33,725
Aktivet me të drejtë përdorimi	170,597	242,025
Aktive të tjera jo afatshkurtra	9,537	9,537
Aktive të tatimit të shtyrë	17,602	47,295
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>16,244,753</b>	<b>16,700,792</b>
<b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>		
Inventarët	2,817,011	2,185,085
Llogari të arkëtueshme	686,549	541,854
Të arkëtueshme të tjera	288,102	251,524
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	47,473	12,064
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	570,512	1,070,950
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>4,409,647</b>	<b>4,061,477</b>
<b>TOTALI I ASETEVE</b>	<b>20,654,400</b>	<b>20,762,269</b>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		
<b>Kapitali</b>		
Kapitali aksionar	10,686,510	10,686,510
Opsione të bazuara në aksione	11,371	6,215
Deficit i akumuluar	(909,049)	(2,398,982)
Rezerva e konvertimit	(28,720)	(14,127)
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>	<b>9,760,112</b>	<b>8,279,616</b>
<b>PASIVET AFATGJATA</b>		
Kredi dhe hua me kamatë	5,781,676	7,129,644
Detyrimet e qirasë	111,603	182,819
Detyrimet tatimore mbi të ardhurat e shtyra, neto	1,071,907	1,115,012
<b>Totali i pasiveve afatgjata</b>	<b>6,965,186</b>	<b>8,427,475</b>
<b>PASIVET AFATSHKURTRA</b>		
Llogaritë e pagueshme	1,254,267	1,608,071
Instrumentet financiare derivative	17,447	-
Llogari të tjera të Pagueshme	153,373	159,824
Tatimi mbi të ardhurat i pagueshëm	72,560	17,496
Kredi dhe hua me kamatë	1,829,295	1,918,497
Detyrimet e qirasë	58,268	63,554
Të pagueshme për palë të lidhura	543,892	287,736
<b>Totali i pasiveve afatshkurtra</b>	<b>3,929,102</b>	<b>4,055,178</b>
<b>TOTALI I PASIVEVE</b>	<b>10,894,288</b>	<b>12,482,653</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>	<b>20,654,400</b>	<b>20,762,269</b>

Tabela e mësipërme është nxjerrë nga Pasqyrat Vjetore Financiare të Konsoliduara të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Grupi i plotë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Konsoliduara për vitin 2022, së bashku me raportin e auditorit të pavarur dhe zbulime të tjera informacionesh bashkëngjitur pasqyrave financiare, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" është publikuar në faqen e internetit të shoqërisë (<https://www.anteacement.com/publications/reports-antea/>).

## PASQYRË E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

(Shumat e shprehura në mijëra ALL përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Opsione të bazuara në aksione	Deficit i akumuluar	Rezerva e konvertimit	Interesat jokontrollues	Totali i kapitalit
<b>Deri me 1 janar 2021</b>	<b>10,686,510</b>	<b>1,826</b>	<b>(3,478,771)</b>	<b>(9,507)</b>	<b>-</b>	<b>7,200,058</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	1,079,789	-	-	1,079,789
Humbje tjetër gjithëpërfshirëse	-	-	-	(4,620)	-	(4,620)
<b>Totali i të ardhurave gjithë përfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,079,789</b>	<b>(4,620)</b>	<b>-</b>	<b>1,075,169</b>
Opsione të bazuara në aksione (shënim 25)	-	4,389	-	-	-	4,389
<b>Deri më 31 dhjetor 2021,</b>	<b>10,686,510</b>	<b>6,215</b>	<b>(2,398,982)</b>	<b>(14,127)</b>	<b>-</b>	<b>8,279,616</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	1,489,933	-	-	1,489,933
Humbje tjetër gjithëpërfshirëse	-	-	-	(14,593)	-	(14,593)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,489,933</b>	<b>(14,593)</b>	<b>-</b>	<b>1,475,340</b>
Opsione të bazuara në aksione (shënim 25)	-	5,156	-	-	-	5,156
<b>Deri me 31 dhjetor 2022,</b>	<b>10,686,510</b>	<b>11,371</b>	<b>(909,049)</b>	<b>(28,720)</b>	<b>-</b>	<b>9,760,112</b>

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE MONETARE

(Shumat e shprehura në mijëra ALL përveç nëse deklarohet ndryshe)

Shënim	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>FLUKSET MONETARE NGA VEPRIMTARITË OPERATIVE</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,818,269</b>	<b>1,237,790</b>
<i>Regullimet për:</i>		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	16/18	970,622
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	17	20,565
Instrumentet financiare derivative	29	17,447
Fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	16,18	(903)
Lëvizje në provigjonet e borxheve të këqija		11,778
Opsione të bazuara në aksione	25	5,156
Të ardhurat nga interesat		(13)
Shpenzime për interesa		366,596
Taksat e shtyra	15	29,693
Humbja/(fitimet) nga këmbimi valutator	31	(263,916)
<b>Regullimet e Kapitalit të Punës</b>		
(Rritja) në inventare	20	(631,926)
(Rritja) e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera	21,22	(321,501)
(Zbritja)/ Rritja e të pagueshmeve tregtare dhe të tjera	28,30	(88,902)

Tabela e mësipërme është nxjerrë nga Pasqyrat Vjetore Financiare të Konsoliduara të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Grupi i plotë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Konsoliduara për vitin 2022, së bashku me raportin e auditorit të pavarur dhe zbulime të tjera informacionesh bashkëngjitur pasqyrave financiare, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" është publikuar në faqen e internetit të shoqërisë (<https://www.anteacement.com/publications/reports-antea/>).

(Shumat e shprehura në mijëra ALL përveç nëse deklarohet dryshe)

Shënim	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Para cash të gjeneruara nga operacionet</b>	<b>1,932,965</b>	<b>2,678,582</b>
Interesi i paguar	(323,922)	(382,129)
Tatimi i paguar mbi të ardhurat	(273,534)	(273,534)
Interesat e arkëtuara	13	11
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë operative</b>	<b>1,335,522</b>	<b>2,022,930</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(570,731)	(170,740)
Blerja e aktiveve jo-materiale	-	-
Të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	14,791	5,788
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë e investimit</b>	<b>(555,940)</b>	<b>(164,952)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese</b>		
Të ardhurat nga huatë	317,756	1,097,564
Shlyerja e huave	(1,460,110)	(2,602,844)
Elementet kryesore të pagesave të qirasë	(78,999)	(79,661)
Pagesat e tarifave	-	(59,024)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese</b>	<b>(1,221,353)</b>	<b>(1,643,965)</b>
<b>Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre</b>	<b>(441,771)</b>	<b>214,013</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 1 janar	23	1,070,950
Efekti i konvertimit të monedhës së huaj	(58,667)	(27,526)
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor</b>	<b>23</b>	<b>570,512</b>

Tabela e mësipërme është nxjerrë nga Pasqyrat Vjetore Financiare të Konsoliduara të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021. Grupi i plotë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Konsoliduara për vitin 2022, së bashku me raportin e auditorit të pavarur dhe zbulime të tjera informacionesh bashkëngjitur pasqyrave financiare, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" është publikuar në faqen e internetit të shoqërisë (<https://www.anteacement.com/publications/reports-antea/>).





## FOKUSIMI NË ÇËSHTJET MATERIALE

Qasja e ANTEA ndaj qëndrueshmërisë është një proces i vijueshëm planifikimi dhe vlerësimi të ndikimit të operacioneve tona në shoqëri dhe mjedis, si dhe ndikimet financiare të rreziqeve socio-mjedisore. Një cikël i plotë i vlerësimit të materialitetit ka një kohëzgjatje prej pesë vjetësh.

Që nga viti 2015, ne kemi ndjekur hapat kryesorë të busullës UNGC SDG ("Udhëzuesi për veprimin e biznesit mbi OZHQ-të", lëshuar nga UNGC dhe GCCA, shih referencën në Deklaratat e Performancës ESG), duke filluar me kuptimin dhe identifikimin e OZHQ-ve përkatëse për biznesin tonë dhe si mund të kontribuojmë në mënyrë domethënëse në arritjen e tyre.


Vlerësimi i materialitetit të ANTEA dhe lidhja me OZHQ-të e vitit 2030 u përditësua në vitin 2021 dhe do të vlerësohet më tej duke marrë reagime nga palët e saj të interesit. Ky raport u hartua me qëllimin për të mbuluar të gjitha çështjet materiale të identifikuara nga procesi i lartpërmendur.

Ne vërtetuan Vlerësimin tonë të Materialitetit në vitin 2022, duke treguar se ndajmë gjykime të ngjashme me palët tona të interesit. ANTEA vazhdon të bazohet në komentet e palëve të interesit dhe rezultatet e vlerësimit të materialitetit drejtojnë procesin për përcaktimin e objektivave tona të ardhshme. Në maj 2022, ne kryem një prezantim dy-javor të pyetësorit elektronik. Ne morëm 100% përgjigje nga palët tona të interesit, me një shkallë plotësimi prej 79%.

Rezultatet e sondazhit rikonfirmojnë njohjen e palëve tona të interesit me objektivat ESG të Grupit TITAN 2025 dhe më tej, si dhe me Raportin tonë të Integruar Vjetor. Pas identifikimit dhe prioritizimit si material për biznesin tonë dhe palët tona të interesit që shikojnë drejt vitit 2025, nuk kishte çështje materiale për t'u marrë në konsideratë. Sipas komenteve nga palët e interesit, një ambient pune i sigurt dhe i shëndetshëm për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit, mbeti çështja më e rëndësishme materiale.

Për më tepër, ne vazhdojmë të investojmë në vendosjen e themeleve për suksesin e vazhdueshëm afatgjatë: zbutjen e rreziqeve dhe duke shfrytëzuar mundësitë që krijon ndryshimi i klimës për biznesin tonë, duke përfituar nga mundësitë e ofruara nga revolucioni dixhital dhe duke vazhduar të ndërtojmë traditën tonë të gjatë të angazhimit të palëve të interesit".


## Cikli i vlerësimit të materialitetit



## Struktura e raportimit të qëndrueshmërisë përfshin:

- Përcaktimin e strategjisë tonë: (Strategjia e përgjithshme e biznesit ► vlerësimi i dyfishtë i materialitetit)
- Zbatimin (Politikat dhe Synimet ► Planet e Veprimit dhe Burimet)
- Matjen e performancës: Arritjet aktuale ► Raporti i kujdeshëm i progresit ndaj objektivave
- Rishikimi dhe raportimi i performancës tek palët e interesit: Subjekti në tërësi ► Temat dhe Nëntemat

## Matrica e Materialitetit



## OZHQ-të përkatëse për çdo çështje materiale

Çështjet materiale 2022	OZHQ-të themelore për BU	OZHQ-të plotësuese
Ambient i sigurt dhe i shëndetshëm pune për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit	3 GOOD HEALTH AND WELL-BEING	8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH, 4 QUALITY EDUCATION
Angazhimi i punonjësve, zhvillimi i vazhdueshëm dhe mirëqenia	3 GOOD HEALTH AND WELL-BEING, 8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH	4 QUALITY EDUCATION, 5 GENDER EQUALITY
Përbushja e kërkesave të konsumatorëve	12 RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION	9 GOOD HEALTH AND WELL-BEING
Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit	12 RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION	16 NET-ZERO EMISSIONS, 17 PARTNERSHIPS FOR THE GOALS
Mbështetja e mirëqenies së komuniteteve tona lokale	4 QUALITY EDUCATION, 11 SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES	17 PARTNERSHIPS FOR THE GOALS
Menaxhimi i mjedisit	12 RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION, 9 INDUSTRY, INNOVATION AND INFRASTRUCTURE	6 CLEAN WATER AND SANITATION, 7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY, 15 LIFE ON LAND
Zinxhiri i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit	12 RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION	9 GOOD HEALTH AND WELL-BEING, 15 LIFE ON LAND
Marrëdhëniet dhe angazhimi i palëve të interesit	9 INDUSTRY, INNOVATION AND INFRASTRUCTURE, 11 SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES	4 QUALITY EDUCATION
Ndryshimi i klimës dhe energjia	13 CLIMATE ACTION	17 PARTNERSHIPS FOR THE GOALS, 7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY
Risi e modelit të biznesit	8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH	

Ne do të vazhdojmë procesin tonë të vlerësimit gjatë gjithë vitit 2023, duke marrë në konsideratë konsultimet me palët e interesuara, duke pasur parasysh që ne zhvillojmë dhe promovojmë OZHQ-të aty ku jemi duke operuar aktualisht. Duke pasur parasysh ndryshimet e rëndësishme që kanë përjetuar të gjitha bizneset gjatë pesë viteve të fundit, ne kemi rishikuar strategjinë tonë të qëndrueshmërisë, kemi zgjeruar qëllimin dhe objektivat tona, ndërsa jemi fokusuar në zbatimin e përpjekjeve bashkëpunuese. Që nga viti 2015, ne kemi ndjekur hapat kryesorë të UNGC OZHQ ("Udhëzuesi për veprimin e biznesit mbi OZHQ-të", publikuar nga UNGC dhe GCCA, shih referencën në Deklaratat e Performancës ESG), duke filluar me kuptimin dhe identifikimin e OZHQ-ve përkatëse për biznesin tonë dhe si mund të kontribuojmë në mënyrë domethënëse në arritjen e tyre.

Vlerësimi i materialitetit të ANTEA dhe lidhja me OZHQ-të e vitit 2030 u përditësua në vitin 2022 dhe do të vlerësohet më tej me komentet nga palët e saj të interesit.

Ne përiqemi të përmirësohemi vazhdimisht përmes procesit të vlerësimit të materialitetit dhe i përmbahemi standardeve globale. E njëjta procedurë ndiqet edhe për mënyrën se si ne raportojmë performancën tonë të qëndrueshmërisë. Rezultatet e vlerësimeve vjetore u përdorën për të mbështetur dialogun e vazhdueshëm me palët e interesit, duke lejuar mirëkuptimin e ndërsjellë, ndërtimin e besimit dhe konsensusit, dhe rrjedhimisht bashkëpunimin në mbështetje të zgjidhjeve afatgjata në të gjitha nivelet. Ky raport u hartua me qëllimin për të mbuluar të gjitha çështjet materiale të identifikuara nga procesi i lartpërmendur.

Për më tepër, ne vazhdojmë të investojmë në vendosjen e themeleve për suksesin e vazhdueshëm afatgjatë: zbutjen e rreziqeve dhe duke shfrytëzuar mundësitë që krijon ndryshimi i klimës për biznesin tonë, duke përfutur nga mundësitë e ofruara nga revolucioni dixhital dhe duke vazhduar të ndërtojmë traditën tonë të gjatë të angazhimit të palëve të interesit'.

## Objektivat ESG për vitin 2025 dhe në vazhdim

Në vitin 2021, Grupi TITAN nisi objektivat Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG) për vitin 2025 dhe më tej, duke u fokusuar në katër zona:

### De-karbonizimi dhe Dixhitalizimi

#### Ambicia

Ne do ta Transformojmë biznesin tonë, duke u fokusuar në qëndrueshmërinë, inovacionin dhe ndërtimin e zgjidhjeve për t'u shërbyer klientëve tanë në mënyrë sa më efektive ndërsa shkojmë drejt një bote neutrale, digjitale ndaj karbonit.

#### Objektivat

- ne do të reduktojmë shkarkimet<sup>1</sup> tona të CO<sub>2</sub> nga 2030, dhe do të vërtetojmë objektivat tona nga Nisma e Objektivave të Bazuar në Shkencë (SBTI) si më poshtë:
- Objektivi 1 (neto): 22.8% deri në 2030 (vs. Niveli 2020)  
Objektivi 1 (neto): 590 kg/t produkt çimento deri në vitin 2025 (-24,0% kundrejt nivelit të 1990)  
500 kg/t produkt çimento deri në vitin 2030 (-35,0% kundrejt nivelit 1990)
- Objektivi 2: 58.1% deri në 2030 (vs. Niveli 2020)
- Objektivi 3  
Objektivi 3 Shkarkimet absolute të GHG nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile të shitura  
- 80.9% deri në vitin 2030 (kundrejt nivelit 2020) Objektivi 3 Shkarkimet e tjera absolute të GHG  
- 90% deri në 2050 (vs. Niveli 2020) 1
- ne angazhohemi të zvogëlojmë gjurmën e CO<sub>2</sub> të operacioneve dhe produkteve tona që aspirojnë të ofrojnë shoqërinë me beton neutral ndaj karbonit nga 2050
- ne do të monitorojmë dhe verifikojmë në mënyrë të pavarur shkarkimet në zinxhirin tonë të furnizimit (Objektivi 3)
- ne do të rrisim investimin tonë vjetor në Kërkim dhe Inovacion deri në 20m €

#### OZHQ-të



#### Çështjet materiale

- Model biznesi i gatshëm për të ardhmen në një botë neutrale ndaj karbonit
- Inovacion duke i vënë theksin digjitalizimit dhe de-karbonizimit

### Ambient pune që mundëson zhvillim

#### Ambicia

Ne do të kultivojmë një kulturë gjithëpërfshirëse me mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit tonë që të rriten profesionalisht brenda një ambienti pune të sigurt dhe të shëndetshëm

#### Objektivat

- ne përplojmë që mos të kemi asnjë fatalitet dhe për një performancë LTIFR të një punonjësi që na vendos vazhdimisht në mesin e tre më të mirëve në grupin<sup>2</sup> tonë të kolegëve
- ne do të zbatojmë iniciativë që adresojnë dimensionet fizike, mendore, shoqërore dhe financiare të mirëqenies për punonjësit tanë, në të gjitha vendet
- ne angazhohemi që 1/3 e anëtarëve tanë të bordit do të jenë gra
- ne do të promovojmë mundësi të barabarta dhe përfshirje dhe do të rrisim me 20% pjesëmarrjen e grave në role të larta, grupe talentesh dhe punësime të reja
- ne do të ofrojmë mundësi përmirësimi dhe rikualifikimi për 100% të punonjësve tanë, veçanërisht në fusha jetike për rritjen e qëndrueshme, si shëndeti dhe siguria, digjitalizimi dhe dekarbonizimi

#### OZHQ-të



#### Çështjet materiale

- Ambient pune i sigurt dhe i shëndetshëm
- Vend pune i larmishëm dhe gjithëpërfshirës
- Zhvillimi i vazhdueshëm i punonjësve tanë

### Ndikim pozitiv lokal

#### Ambicia

Ne do të mundësojmë operacionet tona të biznesit dhe njerëzit tanë në mbarë botën të kontribuojnë për prosperitetin e komuniteteve tona lokale në lidhje me shqetësimet e tyre shoqërore dhe mjedisore

#### Objektivat

- ne do të mbajmë dhe përmirësojmë më tej performancën tonë të fortë në shkarkimet specifike të pluhurit, NOx dhe SOx të lidhur me prodhimin e çimentos
- ne do të kemi plane rehabilitimi të gurorëve në 100% të zonave tona<sup>3</sup> dhe do të rehabilitojmë 25% të zonave të prekura
- ne do të kemi plane të menaxhimit të biodiversitetit të gurorëve në 100% të vendeve tona<sup>4</sup> në zona me vlerë të lartë biodiversiteti
- ne do të kemi plane të angazhimit të komunitetit që janë në përputhje me çështjet materiale për palët e interesuara dhe OZHQ-të e OKB 2030 në 100% të operacioneve tona kryesore
- ne do të sigurojmë që 2/3 e shpenzimeve tona totale t'u drejtohen furnitorëve dhe komuniteteve lokale

#### OZHQ-të



#### Çështjet materiale

- Ndikim pozitiv lokal shoqëror, ekonomik dhe mjedisor

### Burimet përgjegjëse

#### Ambicia

Ne do të fuqizojmë ekosistemet tona të biznesit për të përfshirë konsideratat e qëndrueshmërisë në vendimet e tyre të biznesit dhe sjelljet e përditshme, duke përdorur burimet natyrore me përgjegjësi

#### Objektivat

- ne angazhohemi për një konsum uji prej 280 l/t produkte çimentoje dhe për të mbuluar 70% të kërkesës sonë për ujë me ujë të ricikluar
- ne do të kemi 85% të prodhimit tonë<sup>4</sup> të mbuluar nga ISO 50001 ose auditimet e energjisë
- ne do të kemi 50% të prodhimit tonë<sup>4</sup> të mbuluar nga certifikimi "Zero Mbetje në Landfill"
- ne do të sigurojmë që 70% e furnizuesve tanë kryesorë<sup>5</sup> të përmbushin standardet e furnizuesit TITAN ESG

#### OZHQ-të



#### Çështjet materiale

- Efikasiteti i burimeve, riciklimi dhe rikuperimi, duke kontribuar në ekonominë qarkore
- Zinxhiri i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit

Të gjitha të mbështetura nga: Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit

Objektivi 1: shkarkimet e drejtpërdrejta të CO<sub>2</sub>; Objektivi 2: Shkarkimet indirekte të CO<sub>2</sub> nga energjia elektrike; Objektivi 3: shkarkimet indirekte të CO<sub>2</sub> të zinxhirit të furnizimit Objektivat e vërtetuar nga SBTi

<sup>2</sup> Përkufizimi i grupit të kolegëve: Cemex, Holcim, Argos, HeidelbergCement, CRH, Cementir, Vicat, Buzzi

<sup>3</sup> Sheshe aktive në pronësi të plotë

<sup>4</sup> Prodhimi i fabrikave tona të integruara të çimentos

<sup>5</sup> Furnizuesit kryesorë: furnitorët kritikë sipas Udhezimit GCCA për menaxhimin e Qëndrueshëm të Zinxhirit të Furnizimit me një nivel domethënës shpenzimesh për TITAN

# PËRMbledhje e Performancës së ESG

Me angazhimet ambicioze Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG) për vitin 2025 dhe më tej si pjesë e Grupit TITAN, ANTEA Cement dëshmon përkushtimin e saj të vazhdueshëm ndaj qëndrueshmërisë dhe krijimit të vlerës për të gjithë. Objektivat e Titan ESG përqendrohen në katër shtylla: Dekarbonizimi dhe dixhitalizimi; Mjedi i punës që të ndihmon të rritesh; Ndikimi pozitiv lokal; dhe Burime të përgjegjshme, të gjitha të mbështetura nga qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit. Në seksionin e rishikimit të performancës ESG të raportit të Menaxhimit, ne ofrojmë një përmbledhje të detajuar të performancës sonë vjetore dhe progresit drejt përbushjes së objektivave tona ESG. Aneta Cement promovon kulturën e besimit, transparencës dhe përgjegjësisë, e cila është thelbësore për ruajtjen e qeverisjes së mirë dhe integritetit. Ne jemi të përkushtuar të zbatojmë dhe të monitorojmë performancën tonë të ESG, me përdorimin e standardeve globale dhe specifike të qëndrueshmërisë për sektorin, si dhe me komunikimin transparent mbi ecurinë me palët tona të interesuara.

Për secilën prej çështjeve materiale të identifikuara për ANTEA dhe palët e interesuara, ne paraqesim themelet mbi të cilat kemi ndërtuar dhe përshkruajmë qasjen tonë të menaxhimit për adresimin e tyre, duke theksuar arritjet e rëndësishme të regjistruara gjatë gjithë vitit. Qëndrueshmëria po merr gjithnjë e më shumë rëndësi për ANTEA dhe strategjia e saj është thelbësore që sot të jemi konkurrues dhe të nxisim jetëgjatësinë e saj. Në bashkëpunim me të gjithë palët e interesit përkatëse, autoritetet lokale, rregullatorët, komunitetet, partnerët e biznesit dhe klientët, ANTEA po kontribuon në industrinë e çimentos me qasje novatore për qëndrueshmërinë e biznesit.

Ndryshimet klimatike mbetën padyshim një nga sfidat kryesore dhe çështjet kritike për sektorin, ndërsa ne jemi të përkushtuar të luajmë rolin tonë për një të ardhme neutrale ndaj karbonit duke reduktuar shkarkimet e CO<sub>2</sub>. Menaxhimi dhe zhvillimi i njerëzve, shëndeti dhe siguria në punë, qëndrueshmëria e komuniteteve, menaxhimi i mjedisit kanë qenë në krye të listës së çështjeve materiale të ANTEA. Në vitin 2022, kujdesi për punonjësit tanë, ruajtja e shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve tanë, pajisja e tyre me aftësitë për të qenë të suksesshëm në një mjedis të larmishëm dhe gjithëpërfshirës ka qenë një angazhim i qëndrueshëm për shoqërinë tonë. Ne jemi të sigurt për rolin tonë të biznesit dhe po trajtojmë në mënyrë efektive sfidat kritike, duke luajtur rolin tonë për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë dhe të qëndrueshme së bashku.

## Çështjet materiale të ANTEA në lidhje me Zonat e Fokusit të Grupit TITAN:

### De-karbonizimi dhe Dixhitalizimi

- » Ndryshimet klimatike dhe energjia
- » Risi e modelit të biznesit



### Zonat e fokusit: Ambient pune që mundëson zhvillim

- » Ambient i sigurt dhe i shëndetshëm pune për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit
- » Angazhimi i punonjësve, zhvillimi i vazhdueshëm dhe mirëqenia



### Ndikim pozitiv lokal

- » Menaxhimi i mjedisit
- » Marrëdhëniet me dhe angazhimi i palëve të interesuara
- » Mbështetja e mirëqenies së komunitetit tonë lokal



### Burimet përgjegjëse

- » Efikasiteti i burimeve, riciklimi dhe rikuperimi, duke kontribuar në ekonominë qarkore
- » Zinxhiri i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit
- » Përbushja e kërkesave të konsumatorëve



## ZONAT E FOKUSIT DE-KARBONIZIMI DHE DIXHITALIZIMI

### Çështjet materiale: Ndryshimet klimatike dhe energjia



#### NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ENERGJIA

Ndryshimet klimatike përfaqësojnë një rrezik afatgjatë për planetin dhe shoqërinë tonë. Ato kërkojnë që organizatat e shumë sektorëve në nivel botëror të mobilizohen, mes tyre edhe industria e çimentos.

1.5°C

TITAN është i përkushtuar ndaj qëllimit të Konferencës së 21-të të Parisit për Ndryshimet Klimatike COP21, i cili u riafirmua në COP27 në Sharm el-Sheikh, Egjipt, për të mbajtur rritjen e temperaturës mesatare globale në 1.5°C mbi nivelet para-industriale, dhe për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së 2030

Grupi mbështet gjithashtu vizionin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane për neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050 dhe miraton Ambicien Klimatike të Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA), përpjekje të përbashkëta të industrisë së çimentos drejt neutralitetit të karbonit. Për më tepër, Grupi TITAN nënshkroi Angazhimin për "Ambicien e Biznesit për 1.5°C", një fushatë globale e cila drejtohet nga Nisma e Objektive të Bazuar në Shkencë (SBTi), duke iu bashkuar një numri shoqëri lider globale të cilat janë të angazhuara të mbajnë ngrohjen globale me 1.5°C dhe të arrijnë zero shkarkime neto deri në 2050



Duke nënshkruar letrën e angazhimit "Ambicia e Biznesit për 1.5°C", TITAN iu bashkua gjithashtu fushatës globale "Gara drejt Zeros" të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), e cila inkurajon më shumë shoqëri, qeveri dhe institucione financiare dhe arsimore të mblidhen së bashku dhe të veprojnë për një planet më të shëndetshëm me zero shkarkime karboni.

Grupi aspirojnë të reduktojnë shkarkimet e karbonit me përdorimin e lëndëve djegëse alternative, përpjekjet për efikasitetin e energjisë, prodhimin e produkteve me nivel të ulët karboni, dhe duke miratuar zgjidhje dhe teknologji novatore.



Nëpërmjet pjesëmarrjes në konsorciume evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe përmes bashkëpunimeve në projektet e kërkimit dhe zhvillimit, TITAN do të vazhdojë të zhvillojë produkte çimento me karbon të ulët dhe teknologji pilot të prodhimit dhe përdorimit të karbonit në fabrikat e tij, duke kontribuar në mënyrë aktive në ambicien e industrisë për një të ardhme neutrale ndaj karbonit. Dekarbonizimi ofron mundësi për inovacion dhe rritje, pasi kërkon një ndryshim të thellë të sektorëve të energjisë dhe materialeve të ndërtimit.

A

Në njohje të udhëheqjes së tij në transparencën e korporatave dhe performancën për ndryshimet klimatike, Grupi TITAN mori një pikë të lartë "A" për veprimin klimatik nga organizata jofitimprurëse mjedisore CDP. TITAN është një nga tre shoqëritë e vetme të çimentos në rang ndërkombëtar që ka arritur këtë nivel në vitin 2022.

Grupi TITAN ishte ndër tre shoqëritë e para të çimentos në mbarë botën që vleftësoi objektivat e tij për reduktimin e shkarkimeve të CO2 nga Nisma e Objektive të Bazuar në Shkencë (SBTi) në përputhje me reduktimet e nevojshme për të mbajtur ngrohjen globale në 1.5°C, bazuar në qëllimet e Marrëveshjes së Parisit. Me objektivat e tij të rinj të bazuar në shkencë, TITAN kërkon të trajtojë jo vetëm shkarkimet direkte (Objektivi 1) dhe shkarkimet indirekte nga prodhimi i energjisë elektrike të blerë (Objektivi 2), por edhe shkarkimet e tjera indirekte të zinxhirit të furnizimit (Objektivi 3).

Duke përdorur udhëzimet dhe burimet e ofruara nga SBTi, ne kemi zhvilluar objektivat e reduktimit në përputhje me kriteret e reja dhe i kemi dorëzuar ato në shtator 2022. Pas një procedure të plotë, objektivat që mbulojnë shkarkimet e gazeve serrë nga operacionet e TITAN (objektivat 1, 2 dhe 3) u vërtetuan dhe miratuan.

Pas nismës së Grupit, Antea Cement ka hartuar një plan dekarbonizimi me piketa dhe objektiva të qarta. Duke zbatuar këtë plan, ne aspirojmë të reduktojmë shkarkimet e karbonit me përdorimin e lëndëve djegëse alternative, përpjekjet për efikasitetin e energjisë, prodhimin e produkteve me nivel të ulët karboni, dhe duke miratuar zgjidhje dhe teknologji novatore.

*Objektivat e ESG për vitin 2025 dhe më tej, dekarbonizimi dhe dixhitalizimi i zonës së fokusit*

## Udhërrëfyesi i dekarbonizimit 2030



#### UDHËRRËFYESI I DEKARBONIZIMIT 2030

Në shkurt 2022, Grupi TITAN ka rishikuar udhërrëfyenin e dekarbonizimit Objektivi-1 për arritjen e objektivit tonë 2030. Pjesëmarrja në këtë proces ishte universale dhe ndër-departmentale: stafi drejtues i lartë si dhe ai i mesëm nga departamentet tregtare dhe teknike të të gjitha njësive të biznesit u përfshinë në zhvillimin e këtij udhërrëfyeni, i cili mbulon të gjitha mjetet tradicionale të reduktimit të shkarkimeve të CO<sub>2</sub>:



1. Reduktimi i përmbajtjes së klinkerit në produktin përfundimtar (raporti klinker-çimento)

2. Rritja e shkallës së zëvendësimit termik të lëndëve djegëse fosile me lëndë djegëse alternative



3. Rritja e efikasitetit të energjisë duke reduktuar konsumin specifik të nxehtësisë përmes optimizimit të procesit

Rezultati konfirmoi aftësinë e Grupit për të arritur objektivat e tij të deklaruara siç vërtetohen nga SBTi. Grupi përpiloi një listë të detajuar me mbi 90 veprime dhe projekte, të cilat të gjitha ofrojnë kursime të konsiderueshme në kosto, mundësi rritjeje biznesi si dhe potencial dekarbonizimi.

150 €  
MILIONE

Një shpenzim total kapital midis 100 dhe 150 milionë euro është identifikuar, për t'u shpërndarë relativisht në mënyrë të barabartë përgjatë periudhës 10-vjeçare deri në fund të vitit 2030

47 €  
MILIONE

Akoma më premtuese ishte përshpejtimi i pritshëm i ritmit për të gjithë procesin e dekarbonizimit: nga lista e sipërpërmendur, 13 projekte – të barabartë me rreth 47 milionë euro – ishin tashmë të përfunduara ose në rrugën e duhur për t'u përfunduar deri në fund të vitit 2022/mesi i vitit 2023 (p.sh. instalimi i një sistemi të ri përçues alternativ të lëndëve djegëse dhe një kalcineri i ri në fabrikën e Kamarit, Greqi).

Përveç projekteve të lidhura me CapEx, udhërrëfyeni përfshin nisma tregtare që nuk kërkojnë asnjë investim. Prandaj, përmbajtja e klinkerit në përzjerjen e produktit përfundimtar u reduktua në një nivel të ulët historik për Grupin.



## Çështjet materiale: Model biznesi i gatshëm për të ardhmen në një botë neutrale ndaj karbonit

Në vitin 2022, ne nisëm të shfrytëzojmë avantazhet e ofruara nga inovacioni i modelit të biznesit për tu sjellë dobi klientëve, punonjësve, furnizuesve dhe komuniteteve tona.



ANTEA vazhdoi angazhimin me palët e saj të interesit dhe kontributin në qëndrueshmërinë e komuniteteve lokale duke promovuar dialog të hapur dhe veprime bashkëpunuese me palët e interesit, si dhe duke zbatuar nisma të qëndrueshmërisë në përputhje me çështjet materiale për palët e interesit dhe OZHQ-të e OKB 2030 në 100% të operacioneve të saj kryesore deri në vitin 2025.

Me synimin për të përmirësuar vazhdimisht ndikimin mjedisor të ANTEA, ne monitorojmë dhe raportojmë ndikimin mjedisor, duke vendosur gjithashtu objektiva për reduktimin e shkarkimeve në ajër, mbrojtjen e biodiversitetit, rehabilitimin e guroreve, menaxhimin dhe riciklimin e ujit.

ANTEA angazhohet në një proces afatgjatë me ekspertë dhe palë të interesuara, në përputhje me politikën tonë mjedisore, duke kërkuar mënyra kuptimplota për të kuptuar nevojat e shoqërisë dhe për të kontribuar në një ndikim neto pozitiv lokal për komunitetet ku operojmë.

## Objektivi i përgjithshëm Net-Zero

TITAN është i përkushtuar të arrijë shkarkimet zero neto të GHG-ve në të gjithë zinxhirin e vlerës deri në vitin 2050 nga viti bazë 2020.

### Objektivat afatshkurtra të vërtetuara

TITAN angazhohet për:



Reduktimin e shkarkimeve bruto të objektivit 1, 2 dhe 3 të GHG, duke mbuluar çimento dhe klinker të prodhuar dhe blerë me 25.1% për ton produkt çimento të shitur deri në vitin 2030 nga viti bazë 2020.



Reduktimin e shkarkimeve bruto të objektivit 1 me 22.8% për ton produkt çimento deri në vitin 2030 nga viti bazë 2020. Ky objektivi është në përputhje me objektivin e reduktimit të CO2 prej 35% në shkarkimet neto deri në vitin 2030 nga viti bazë 1990, i shpallur nga TITAN në 2020.



Reduktimi i shkarkimeve të GHG-ve të Objektivit 2 me 58.1% për ton produkt çimento nga viti bazë 2020.



- Lidhja e dhënies së informacioneve shpjeguese sipas Shënimit 7 të "Shënimeve për KPI-të specifike" të mësipërme, në lidhje me progresin e vitit 2022, në përputhje me Udhërrëfyesin e Qëndrueshëm të Zinxhirit të Furnizimit të TITAN, mbulon kërkesat për raportim sipas Standardeve të SASB për fushën "Etika dhe Transparenca e Biznesit", dhe më konkretisht matricën (KPI) EM-MM-510a.1. Lidhja ka të bëjë me përshkrimin e sistemit të menaxhimit për parandalimin e korrupsionit dhe ryshfetit në të gjithë zinxhirin e vlerës.

#### Sheshet e fabrikës së çimentos të Grupit TITAN në zonat me mungesë të theksuar uji

Vendndodhja	Shteti	Mungesa e ujit (Baza)
Antea	Shqipëri	>80%

#### Shënime

1. Vlerësimi i rrezikut të ujit për të gjitha sheshet e Grupit TITAN u krye në vitin 2020 me përdorimin e mjetit të Kanalit të Institutit të Burimeve Botërore (IBB).

2. Tabela e mësipërme paraqet sheshet e fabrikës së çimentos (si përdoruesit më të mëdhenj të ujit mes aktiviteve të Grupit) që operojnë brenda zonave me mungesë uji, përkatësisht brenda zonave ku Treguesi Bazë i Mungesës së Ujit është >40%, siç klasifikohet nga mjeti i Kanalit.

3. Treguesi i mungesës së ujit mat raportin e tërheqjeve totale të ujit me furnizimet e disponueshme të ripërtëritshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Vlerat më të larta tregojnë më shumë konkurrencë midis përdoruesve.

4. Ky informacion për aktivitetet që kryhen në zonat me mungesë uji së bashku me informacionet në seksionin "Pasqyra e performancës jofinanciare" të këtij raporti, mbulojnë gjithashtu kërkesat për raportim sipas Standardeve të SASB për "Menaxhimi i Ujit" dhe në mënyrë më specifike KPI EM-CM-140a.1 "(1) Sasia totale e ujërave të ëmbla të tërhequra, (2) përqindja e ricikluar, (3) përqindja në rajonet me mungesë jashtëzakonisht të lartë ose të theksuar uji".

## 2.5 Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit

### 2.5.1 Treguesit Bazë të Qeverisjes

#### Përputhshmëria dhe etika e biznesit

kodi	Treguesit Bazë të Qeverisjes	Shënime	Performanca 2022	Standardet e Raportimit
5.1	Përqindja e punonjësve që janë pjesë e sindikatave(%)		34.92%	OZHQ 5.5 OZHQ 16.5 OZHQ 16.6 OZHQ 16.7
5.3	Përqindja e punonjësve që përfshihen në Marrëveshjet Kolektive (CBA-të)	2	100.00%	UNGC UNCTAD SASB
5.4	Numri mesatar i orëve të trajnimit për tema që lidhen me Përputhshmërinë, për çdo punonjës	3	2.90	
5.5	Trajnim kundër rryshfetit dhe korrupsionit	1, 3		

#### Shënime për KPI-të specifike

- Treguesit i ri.
- Në vitin 2022, kjo përqindje arriti në 50.33% [në nivel grupi], paksa e ulur krahasuar me 52.3% [në nivel grupi] në vitin 2021.
- Numri mesatar i orëve të trajnimit për çdo punonjës dhe në vit, mbi politikën dhe procedurat e brendshme të TITAN (përparësi është Kodi i Sjelljes, Politikën për të Drejtat e Njeriut, Anti-Ryshfeti, GDPR, megjithëse kjo listë nuk duhet të konsiderohet si shteruese), KPI llogaritet si orë totale të trajnimit për temat pjesëtuar me numrin total të punonjësve. TITAN i kategorizon këto tema trajnimi nën temën e përgjithshme: "Përputhshmëria" (shihni Tabelën 2.2 "Tema: Mjedisi i punës që mundëson rritje", për KPI-në "Orë trajnimi për lëndë, totali në nivel grupi"). Po ashtu, TITAN ka publikuar edhe numrin total të orëve të trajnimeve kundër rryshfetit dhe korrupsionit në vitin 2022, lidhur me sa më sipër. Ky informacion nxirret nga sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore në çdo vend dhe konsolidohet në nivel Grupi duke ndjekur të njëjtat rregulla dhe praktika si të dhënat e mësipërme për trajnimet e përputhshmërisë.

#### Shënime shtesë

- TITAN nuk operon në ose afër zonave të konfliktit, sipas të dhënave të Programit të të Dhënave të Konfliktit të Uppsala UCDP - shihni faqen e internetit. Programi i të dhënave të konfliktit në Uppsala (uu.se).
- Në vitin 2022, TITAN ndoqi një proces të zgjeruar të marrjes së reagimeve nga palët tona të interesit në çdo vend ku operon, duke promovuar parimet e komunikimit të hapur dhe të strukturuar dhe zbatoi një projekt për validimin e matricës ekzistuese të materialitetit në nivel të çdo BU. Për më shumë detaje, shihni seksionin "Përqendrimi në çështjet materiale" të këtij raporti dhe më konkretisht "Materialiteti dinamik". Në lidhje me rezultatet e Projektit të Materialitetit të Validimit të BU 2022, shihni Tabelën 1.1 "Çështjet materiale", pjesë e deklaratave të performancës ESG.
- Rreth punës bazë: Puna përgatitore për analizën dhe vlerësimin e Vlerësimit të Materialitetit për të gjitha vendet e operacioneve përfundoi në vitin 2020, duke përfshirë kërkime të fokusuara në çdo vend nga një palë e tretë. Ky proces mundësoi angazhimin e stafit drejtues të TITAN-it në secilin vend ku operon, dhe vigjilencën e duhur të dëshmuar në nivel BU në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popullsisë vendase dhe konfliktet e mundshme të lidhura me to. Hulumtimi në nivel vendi arriti në përfundimin se nuk ishte shfaqur dhe as nuk pritej asnjë çështje konfliktit në lidhje me sa më sipër. Asnjë informacion i ri mbi këtë temë nuk u vu re të publikohej në shtyp/media në asnjë nga vendet e operacioneve tona, as në vitin 2021 dhe as në vitin 2022.
- Në vitin 2022, TITAN vijoi të zhvillohej, duke vënë në funksionim një platformë elektronike të dedikuar të Grupit për të regjistruar iniciativat dhe veprimet tona të komunitetit në çdo nivel BU, si dhe për të lehtësuar vetëvlerësimin dhe përafrimin e BU-ve me objektivat e Grupit dhe prioritetet kryesore. Planet e Angazhimit të Komunitetit zbatohen në të gjitha vendet ku ne operojmë, duke mbuluar programe iniciativash për të kontribuar në qëndrueshmërinë e komuniteteve lokale dhe për të rritur angazhimin me palët tona të interesit, duke synuar ndikime pozitive afatgjata për komunitetet dhe shoqërinë. Shihni seksionin "Ndikimi pozitiv social" në Raportin e Menaxhimit për vlerësimin e nismave të angazhimit të komunitetit të TITAN në të gjitha vendet e operimit në 2022.
- Asnjë incident nuk u regjistrua në vitin 2022 në lidhje me mbylljet e kantierëve ose vonesat e projekteve për shkak të faktorëve jo teknikë, të tillë si ato që rezultojnë nga lejet rregullatore në pritje ose vonesat e tjera politike që lidhen me shqetësimet e komunitetit, rezistencën ose protestën e komunitetit ose të palëve të interesit dhe konfliktet e armatosura.

#### Lidhja e KPI-ve dhe informacione në lidhje me Standardet SASB

- Informacionet e Shënimit 6 (më sipër) për përqindjen e punonjësve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive dhe numrin dhe kohëzgjatjen e grevave dhe bllokimeve mbulojnë kërkesat për raportim sipas Standardeve të SASB për temën (fushën) "Marrëdhëniet e Punës" dhe në mënyrë specifike matricat (KPI) EM-MM-310a.1 dhe EM-MM-310a.2.

### 2.5.3 Politikën ESG dhe Kodi i Sjelljes

	Të reja ose të përditësuara në vitin 2022	Temat më të rëndësishme në fokus të TITAN				
		De-karbonizimi dhe Digjitalizimi	Mjedisi pune që të ndihmon të rritet	Ndikim pozitiv lokal	Burimet e përgjegjshme	Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit
Kodi i sjelljes			•			•
Kodi i Sjelljes së Prokurimit	✓			•	•	•
<b>Politikën e Grupit</b>						
Politikën kundër rryshfetit dhe korrupsionit						•
Politikën e Përputhshmërisë me Ligjin për Konkurrencën						•
Politikën e konflikteve të interesit						•
Politikën e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR).				•		
Politikën e mbrojtjes së të dhënave personale			•			•
Politikën e Barazisë dhe Përfshirjes së Diversitetit (DE&I).	✓		•			
Politikën Mjedimore (përfshirë ndryshimet klimatike)		•		•	•	
Politikën e të Drejtave të Njeriut			•	•	•	•
Politikën e Sigurisë së Informacionit		•				•
Politikën për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (OH&S)			•			
Politikën e Prokurimit				•	•	
Politikën e Sanksioneve						•
Politikën e Sinjalizimit						•

### 2.5.4 Sistemet e Menaxhimit të Grupit

Fusha	Shëndeti dhe Siguria	Ambienti	Cilësia	Energjia	Aspekti social
Shqipëri	ISO 45001 Të gjitha operacionet (përfshirë terminal)	ISO 14001 Të gjitha operacionet (përfshirë terminal)	ISO 9001 Të gjitha operacionet		GHRMS/SF dhe SA 8000 Të gjitha operacionet

### 2.5.5 Kontributet politike dhe gjokat dhe sanksione të tjera jomonetare

Shteti	Kontributet politike <sup>1</sup> (në euro)	Gjoka të konsiderueshme <sup>2</sup> (në euro)	Numri total i sanksioneve jo-monetare <sup>2</sup>
Shqipëri	0	0	0

#### Shënime

##### Lidhja e KPI-ve dhe informacione në lidhje me Standardet SASB

Zbulimet e mësipërme të informacioneve mbulojnë kërkesat për raportim sipas Standardeve të SASB për "Integritetin dhe Transparençën e Çmimeve" dhe në mënyrë më specifike matricën (KPI) EM-CM-520a.1. "Shuma totale e humbjeve monetare si rezultat i procedurave ligjore të lidhura me aktivitetet e kartelit, fiksimit dhe çmimeve dhe aktivitetet anti-trust".

## 2.5.6 Audimet mjedisore

Fusha	Shqipëri	
Sistemi i Menaxhimit Mjedisor	I jashtëm	2
	I brendshëm	1
Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/Auditimet e Energjisë	I jashtëm	0
	I brendshëm	0
Shkarkimet e CO <sub>2</sub>	I jashtëm	0
	I brendshëm	0
Menaxhimi i Mbetjeve	I jashtëm	0
	I brendshëm	0
Ankesat	I jashtëm	0
	I brendshëm	0
Lejet	I jashtëm	1
	I brendshëm	0
Të tjera	I jashtëm	1
	I brendshëm	0
<b>TOTALI</b>	<b>I jashtëm</b>	<b>4</b>
	<b>I brendshëm</b>	<b>1</b>

## 2.5.7 Raport i Konsoliduar mbi Pagesat për Qeveritë për operacionet nxjerrëse

Subjekti ligjor	Shteti	Llojet e Pagesave	Shuma
Cementi Antea Sha	Shqipëri	Tarifat e nxjerrjes	458401
		<b>TOTALI</b>	<b>458401</b>

## 2.5.9 Sektori dhe standardet e tjera për zbulimet e informacioneve jofinanciare në vitin 2022

Nisma ose Shoqata e Sektorit	Udhëzuesit dhe dokumente të tjera reference	Publikuar
GCCA <sup>1</sup>	Karta e Qëndrueshmërisë Udhëzuesit e Kuadrit të Qëndrueshmërisë Udhëzuesit e Qëndrueshmërisë për monitorimin dhe raportimin e sigurisë në prodhimin e çimentos dhe betonit. Për këtë dokument është rënë dakord brenda GCCA që të ketë një zbatim të gjerë në aktivitetet konkrete dhe aktivitetet të tjera të lidhura. [Shtylla 1] Udhëzuesit e Qëndrueshmërisë për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO <sub>2</sub> nga prodhimi i çimentos [Shtylla 2] Udhëzuesit e Qëndrueshmërisë për monitorimin dhe raportimin e ujit në prodhimin e çimentos [Shtylla 4] Udhëzuesit e Qëndrueshmërisë për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve nga prodhimi i çimentos [Shtylla 4] Udhëzuesit e qëndrueshmërisë për përpunimin e përbashkët të lëndëve djegëse dhe lëndëve të para në prodhimin e çimentos [Shtylla 5] Udhëzuesit e qëndrueshmërisë për rehabilitimin e gurove dhe menaxhimin e biodiversitetit [Shtylla 4] Udhëzimet për Menaxhimin e Qëndrueshmërisë të Zinxhirit të Furnizimit [Shtyllat 1, 3 and 5]	Botimi më i fundit (publikimet ndërmjet vitit 2019 dhe 2021)
Plotësues i standardeve GCCA: (Më parë) WBCSD/CSI	Praktikat e mira të rekomanduara për: (a) Sigurinë e Kontraktorit dhe (b) Sigurinë e Drejtimit të mjetit Objektiv 3 i Sektorit të Çimentos Udhëzime për Kontabilitetin dhe Raportimin e GHS	2009 2016
UNCTAD <sup>2</sup>	Udhëzime për Treguesit Bazë për Raportimin e Ndikimit të Qëndrueshmërisë dhe OZHQ	2022
UNGC COP <sup>3</sup>	Udhëzues për Pyetëtorin për COP	2022

## Shënime

1. Shoqata Globale e Çimentos dhe Betonit (GCCA) ka hartuar Kartën e saj të Qëndrueshmërisë me në qendër pesë (5) Shtyllat e Qëndrueshmërisë, për të përfshirë spektrin e plotë të qëndrueshmërisë për qëllimet e saj të punës.  
Shtylla 1: Shëndeti dhe Siguria, Shtylla 2: Ndryshimet klimatike dhe energjia, Shtylla 3: Përgjegjësia Sociale, Shtylla 4: Mjedi dhe Natyra dhe Shtylla 5: Ekonomia Qarkore. Terminologjia e "Shtyllave" është specifike për Kartën e angazhimeve të GCCA për shoqëritë anëtare dhe detajet janë të disponueshme në Kartën dhe Udhëzimet Kuadër në faqen e internetit të GCCA: <https://gccassociation.org/sustainability-innovation/sustainability-charter-and-guidelines/>  
TITAN vijoi përpjekjet në vitin 2022 për zbatimin e Udhërrëfyesit të GCCA 2050 drejt "E ardhmja e betonit" me zero neto beton dhe u fokusua në objektivat SBTI për skenarin 1.5 gradë, duke vijuar pjesëmarrjen aktive në grupe të ndryshme pune dhe duke kontribuar me njohuri dhe ekspertizë, në përputhje me praktikën e ndjekur që nga themelimi i Shoqatës Sektoriale.  
Në vitin 2022, TITAN mori pjesë në Auditimin e parë të Kartës së Përputhshmërisë të GCCA, me objektiva të cilat përfshijnë (a) mbështetjen e anëtarëve në zhvillimin e zbatimit të strategjisë së tyre të qëndrueshmërisë (të fokusuar, por jo kufizuar vetëm në detyrimet e GCCA), (b) vlerësimin e performancës së qëndrueshmërisë së anëtarëve dhe ruajtjen e standardeve me shoqëritë homologe, (c) identifikimin e fushave ku udhëzimet dhe statuti i GCCA duhet të qartësohen ose forcohen.  
2. Udhëzimi i UNCTAD ofron lidhje kuptimplotë të KPI-ve me OZHQ-të më të rëndësishme dhe objektivat specifike për secilin OZHQ dhe është përdorur sipas qasjes raportuese të TITAN për të gjitha temat që lidhen me dekarbonizimin dhe digjitalizimin, mjedisin e punës që mundëson rritje, temat me ndikim pozitiv lokal, burimet e përgjegjshme dhe mirëqeverisjen, transparencën dhe etikën e biznesit.  
3. Udhëzimi i UNGC COP u përmirësua në vitin 2022 dhe konsiderohet thelbësor për raportimin lidhur me progresin në lidhje me angazhimet e TITAN për Dhjetë Parimet e UNGC. Shihni Tabelën 2.5.11 për detaje mbi udhëzimin e UNGC COP dhe lidhjet specifike me KPI-të dhe publikime të tjera në këtë Raport.  
Në përgjithësi: Tabelat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5.1, 2.5.10 dhe 2.5.11 ofrojnë referenca dhe lidhje për standardet sipas shënimeve të mësipërme (1), (2) dhe (3).

## 2.5.10 Treguesit e krijimit të vlerës

Treguesit bazë të krijimit të vlerës <sup>1</sup>	Njësia	2022
Shpenzimet totale për furnizuesit lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mallra dhe shërbime <sup>2</sup>	milion €	86,83
% e shpenzimeve lokale të TITAN <sup>2b</sup>	%	60,26
Taksat ndaj autoriteteve kombëtare dhe lokale <sup>3</sup>	milion €	7,13
Pagesat me para cash për aksionarët dhe pakicat <sup>3</sup>	milion €	0.0
Investimet sociale (në para dhe në natyrë) për iniciativat komunitare <sup>4</sup>	milion €	92,500
Lëndët e para dhe lëndët djegëse alternative	milion t	
Pagesat (kontributet) për pensionet dhe përfitimet sociale, duke përfshirë përfitimet shtesë përtej atyre të parashikuara me ligj <sup>5</sup>	milion €	3,7
Investimet në trajnimin e punonjësve të punësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë <sup>6</sup>	milion €	52,692
Praktikat	#	7
Shpenzimet e kapitalit <sup>7</sup>	milion €	4,8

## Shënime

Shënimet e mëposhtme përfshijnë përkufizime për termat e përdorur posaçërisht për krijimin dhe shpërndarjen e vlerës te palët e interesit.

## Shënime për standardet, udhëzimet dhe termat e përdorur

Shumica e termave që lidhen me Treguesit Bazë të Krijimit të Vlerës u miratuan nga "Udhëzuesi mbi treguesit bazë për subjektin që raporton mbi kontributin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshmërisë" (shkurt: Udhëzimi i UNCTAD, 2022), dhe i përfshirë në seksionin e standardeve të TITAN. Termat përkatëse janë përshkruar këtu dhe lidhen me KPI-të në Indeks in e mësipërm. Shifrat për Treguesit Bazë të Krijimit të Vlerës Jepen në "Të kuptojmë TITAN, Krijimi dhe ndarja e vlerave".

1. Vlera ekonomike e krijuar dhe e shpërndarë te palët kryesore të interesit është llogaritur sipas Kombeve të Bashkuara UNCTAD "Udhëzime mbi treguesit bazë për subjektin që raporton mbi kontributin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshmërisë" (botimi 2022).

2a. Sipas Standardeve të TITAN dhe zbatimit të SNRF-ve, dhe në përputhje me qasjen për "% e shpenzimeve lokale të TITAN".

2b. Raporti i shpenzimeve për furnitorët vendas ndaj shpenzimeve totale për të gjithë furnitorët, i shprehur si përqindje. Kostot e prokurimit lokal janë një tregues i përgjithshëm i shtrirjes së lidhjeve të një subjekti me ekonominë lokale (Udhëzuesi i UNCTAD, 2022). "Lokal" janë ata furnitorë që ofrojnë mallra ose shërbime për TITAN dhe kanë numër regjistrimi tatimor brenda vendit me interes. I njëjtë me vendin ku ndodhet dhe ku kanë numrin e regjistrimit tatimor BU-të e TITAN. Për vendet me një strukturë qeveritare që funksionojnë si federatë shtetesh, kjo vlen veçanërisht sot për SHBA, ku shtete të ndryshme kanë qeverisje vendore dhe shtrirje të gjerë gjeografike, termi "lokal" u referohet atyre furnitorëve ku shoqëria është regjistruar në të njëjtin shtet ku nga ana fiskale është regjistruar edhe BU ose vendndodhja e operacioneve, si dhe në shtetet që janë fqinje me shtetin e BU ose vendndodhjen e operacioneve (përkufizimi vlen për operacionet e TITAN në SHBA, për figurën e mësipërme të KPI). TITAN publikon KPI-në përkatëse me të dhëna historike në Tabelën 2.3 të Deklaratave të Performancës ESC.

3. Sipas Standardeve të TITAN dhe zbatimit të IFRS, shih Pasqyrat Financiare.

4. "Investimet sociale" si shpenzime totale të kryera në para dhe në natyrë, si dhe investime në fonde (si shpenzimet kapitale ashtu edhe ato operative) për nismat komunitare të BU të TITAN. Shihni Tabelën 2.3.2 lidhur me Planet e Angazhimit të Komunitetit për detaje. Përfituesit e synuar ishin palët e interesit në komunitetet më të gjera, ndërsa punonjësit e TITAN nga komunitetet lokale u përfshinë si përfitues të nismave specifike për angazhimin e komunitetit. Gjithashtu, duke iu referuar Tabelës 2.3.2, shumica e "Donacioneve" raportohet si ekuivalente me donacionet bamirëse/vullnetare dhe investimet e fondeve (qasja është në përputhje me Udhëzuesin e UNCTAD, 2022).

5. Sipas Standardeve të TITAN dhe zbatimit të IFRS, shih Pasqyrat Financiare.

6. Shpenzimet totale duke përfshirë kostot e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të trajnimit për punonjësit e punësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë (përfshirë kostot si tarifën e trajnerëve, ambientet e trajnimit, pajisjet e trajnimit, kostot përkatëse që lidhen me udhëtimin etj.) të raportuara gjithashtu për çdo punonjës dhe çdo vit, dhe të ndara sipas kategorisë së punonjësve (Udhëzuesi i UNCTAD, 2022). TITAN publikon KPI-në përkatëse me të dhëna historike në Tabelën 2.2 të Deklaratave të Performancës ESC.

7. Shpenzimet e kapitalit, të njohura zakonisht si CapEx, janë fonde që përdoren nga një shoqëri për të blerë, përmirësuar dhe mirëmbajtur pasuri fizike si pronë, ndërtesa, një fabrikë industriale, teknologji ose pajisje.

2.5.11 Lidhja e publikimeve tona me COP të TITAN sipas platformës së përmirësuar të UNGC

Seksionet <sup>1</sup>	Pyetje <sup>1</sup>	Parimet UNGC <sup>1</sup>	Referenca me Raportin <sup>1</sup>
Qeverisja	C1: Angazhimi i bordit/stafit të lartë drejtues	1,7,10	<b>Të kuptojmë TITAN</b> Rreth raportit Përmbledhje Momente kyçe të performancës: Mirëqeverisja, transparenca dhe etika e biznesit  <b>Raporti i stafit drejtues</b> Qeverisja e korporatës dhe menaxhimi i rrezikut: Deklarata e Qeverisjes së Korporatës Rishikimi i performancës së ESG: Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Deklaratat e performancës së ESG: Qasja e TITAN-it për raportimin e performancës ESG, dhe tabelat 2.5.1, 2.5.3.
	C2: Angazhimi i deklaruar publikisht		
	C3: Kodi i sjelljes		
	C4: Përgjegjësi individuale ose në grup		
	C5: Struktura formale		
	C6 dhe C.6.1: Proceset e vlerësimit të rrezikut		
	C7 dhe C7.1: Vigjilenca e duhur		
	C9: Mësimet		
	C10: Paguesa e ekzekutivit në lidhje me performancën		
	C12: Raportimi i qëndrueshmërisë		
Të Drejtat e Njeriut <sup>2</sup>	HR1: Tematikat materiale	1,2	<b>Të kuptojmë TITAN</b> Përmbledhje Pikat kyçe të performancës : Përqendrimi në çështjet materiale dhe angazhimi i palëve të interesit <b>Raporti i stafit drejtues</b> Qeverisja e korporatave dhe menaxhimi i rrezikut Rishikimi i performancës së ESG: Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Deklaratat e performancës së ESG: Tabelat 1.1, 2.5.1, 2.5.3 - 2.5.7, 2.5.9.
	HR2 dhe HR2.1: Angazhimi i politikës		
	HR3: Angazhimi i palëve të interesit		
	HR4: Parandalimi/zbutja		
Puna	HR5: Trajnimi formues	3,4,5,6	<b>Të kuptojmë TITAN</b> Përmbledhje Pikat kyçe të performancës : Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Performanca e ESG  <b>Raporti i stafit drejtues</b> Qeverisja e Korporatës dhe menaxhimi i rrezikut Rishikimi i performancës ESG: Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Deklaratat e performancës së ESG: Tabelat 1, 2.5.2, 2.5.3 - 2.5.7, 2.5.9.
	HR6: Vlerësimi i progresit të parandalimit/zbutjes		
	HR8: Masat praktike		
	L1 dhe L1.1: Angazhimi i politikës		
	L2: Angazhimi i palëve të interesit		
	L3: Parandalimi/zbutja		
	L4: Trajnimi formues		
	L5: Vlerësimi i progresit të parandalimit/zbutjes		
	L9: Frekuenca e lëndimeve		
	L10: Shkalla e incidenteve		
Mjedisi	L11: Zgjidhjet ligjore	7,8	<b>Të kuptojmë TITAN</b> Përmbledhje Pikat kyçe të performancës Performanca e ESG  <b>Raporti i stafit drejtues</b> Qeverisja e Korporatës dhe menaxhimi i rrezikut Rishikimi i performancës ESG: Tema në fokus: Dekarbonizimi dhe digjitalizimi, mjedisi i punës që mundëson rritje, ndikim pozitiv lokal, burime të përgjegjshme Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Deklaratat e performancës së ESG: Tabelat 2.1.1, 2.3.1. dhe Tabela plotësuese e Zonave të Curore të Grupit TITAN me vlerë të lartë të biodiversitetit, gjithashtu Tabelat 2.4.1, 2.5.2, 2.5.3.
	L12: Masat praktike		
	L1.2: Liria e organizimit dhe e negociatave kolektive		
	L6: Marrëveshjet kolektive		
	L7: Gratë në poste drejtuese		
	E1 dhe E1.1: Angazhimi i politikës		
	E2: Angazhimi i palëve të interesit		
	E3: Parandalimi/zbutja		
	E4: Vlerësimi i progresit të parandalimit/zbutjes		
	E4.1: Objektivat dhe synimet		
E4.2: Matja e ecurisë përkundër synimeve			
E6: Shkarkimi i gazrave me efekt serë			
E6.1: Objekti 2 detajet e shkarkimeve			
E14: Shndërrimi i ekosistemeve natyrore			
E16: Ndotja e ajrit			
E17: Mbetjet			
E18: Mbetje të rrezikshme			
E7: Investimet në kërkim dhe zhvillim në produkte dhe shërbime me karbon të ulët			
E8: Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike			
E9: Energjia e rinovueshme			
E10: Produkte/shërbime me karbon të ulët			
E11: Marrja dhe konsumi i ujit			
E12: Intensiteti i ujit			
E13: Vende në ose pranë zonave kryesore të biodiversitetit			
E15: Restaurimi dhe mbrojtja e ekosistemit			
E20: Masat praktike			
E: Sektori (Ndërtimi dhe materialet)			

Seksionet <sup>1</sup>	Pyetje <sup>1</sup>	Parimet UNGC <sup>1</sup>	Referenca me Raportin <sup>1</sup>
Anti-korrupsion	AC1 - Deklarata e përputshmërisë;	10	<b>Të kuptojmë TITAN</b> Pikat kyçe të performancës  <b>Raporti i stafit drejtues</b> Qeverisja e Korporatës dhe menaxhimi i rrezikut Rishikimi i performancës ESG: Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit Deklaratat e performancës së ESG: Tabelat 2.5.1, 2.5.3-2.5.7, 2.5.9.
	AC1.1 Viti i rishikimit të programit		
	AC2 Politikat		
	AC3 Trajnimet		
	AC3.1 Frekuenca e trajnimit		
	AC4 Monitorimi i përputshmërisë		
	AC5 Incidentet e korrupsionit		
	AC6 Masat për trajtimin e incidenteve të dyshuara të korrupsionit		
AC7 Veprime kolektive kundër korrupsionit			
AC8 Masat praktike			

Shënime

1. Lidhja midis 'Pyetjeve' sipas COP me kodifikimin specifik sipas fushave të ndryshme të Pyetësorit dhe Dhjetë Parimeve të UNGC-së lehtësohet nga referencat në Raport (duke përfshirë deklaratat e performancës së ESC). Për lidhjen me OZHQ, shihni referencat në Tabelat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, të deklaratave të performancës ESC.  
 2. Në lidhje me fushën e të drejtave të njeriut: TITAN nuk operon në ose afër zonave të konfliktit, sipas të dhënave të Programit të të Dhënave të Konfliktit të Uppsala UCDP - shihni faqen e internetit: Programi i të dhënave të konfliktit në Uppsala (uu.se). Në vitin 2022 TITAN zbatoi një projekt për vërtetimin e matricës ekzistuese të materialitetit në nivel të çdo BU (shih seksionin "Përqendrimi në çështjet materiale"), i cili mundësoi angazhimin e stafit drejtues të TITAN-it në çdo vend ku operon dhe vigjilencën e duhur në nivel BU në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popullsisë vendase dhe konfliktet e mundshme të lidhura me to. Asnjë çështje konflikti në lidhje me sa më sipër nuk u shfaq dhe nuk pritet të ndodhë. Asnjë informacion i ri mbi këtë temë nuk u vu re në shtyp/media në asnjë nga vendet ku kryejmë operacione. Asnjë incident nuk u regjistrua në vitin 2022 në lidhje me mblylljet e kantierëve ose vonesat e projekteve për shkak të faktorëve jo teknikë, të tillë si ato që rezultojnë nga lejet rregullatore në pritje ose vonesat e tjera politike që lidhen me shqetësimet e komunitetit, rezistencën ose protestën e komunitetit ose të palëve të interesit dhe konfliktet e armatosura.

Lidhja e KPI-ve dhe publikimeve të tjera me standardet e SASB

- Duke iu referuar Shënimit të mësipërm 4, ne mbulojmë kërkesat për raportim sipas standardeve të SASB për dy tema (fusha): "Siguria, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popullsisë vendase" dhe më specifikisht matricat (KPI) EM-MM-210a.1, EM-MM-210a.2 dhe EM-MM-210a.3, dhe "Marrëdhëniet me Komunitetin", në mënyrë më specifike matricat (KPI) EM-MM-210b.1 dhe EM-MM-210b.2, në lidhje me diskutimin e procesit për të menaxhuar rreziqet dhe mundësitë që lidhen me të drejtat dhe interesat e komunitetit.  
 - Lidhur me temën (fushën) "Etika e Biznesit dhe Transparenca" dhe në veçanti lidhjen me matricën (KPI) EM-MM-510a.2, shihni tabelën plotësuese "Transparency International - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022".

Transparency International - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

Vendet me operacionet kyçe të TITAN në renditura sipas Indeksit të Transparency International CP 2022


Shteti	Renditja CPI 2022	Renditja CPI 2021	Ndryshimi në gradë <sup>2</sup>
Shqipëri	101	110	▼

Shënime

1. Sipas Tabelës së mësipërme, nuk ka pasur operacione në filialet e TITAN në vendet me renditje më të ulët se Egjipti, në 2022. Ka një total prej 45 vendesh me renditje më të ulët, në pozicione nga 136 deri në 180, në vitin 2022. Ky publikim mbulon kërkesat për raportim sipas Standardeve SASB për "Etikën e Biznesit dhe Transparençën", dhe në mënyrë më specifike matricën e KPI EM-MM-510a.2 "Prodhimi në 20 vendet me renditjen më të ulët në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International".

"2. Simbolet për ndryshimin në shkallës shpjegohen:  
 ▼ Përmirësimi i kushteve në vend reflektohet nga rënia e shkallës  
 ▲ Përqendrimi i kushteve në vend është reflektuar nga rritja e shkallës

# RAPORTI I AUDITUESIT



## Raport i Pavarur i Sigurisë së Limituar

### Informacion i përgjithshëm

Bordi Drejtues i ANTEA CEMENT sh.a. ("Shoqëria") angazhoi "GRANT THORNTON sh.p.k." ("Grant Thornton") për të rishikuar informacionet jo-financiare të paraqitura në Raportin Vjetor të Integruar 2022 ose në Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë 2022 të Shoqërisë (referuar më tej në këtë Raport të Pavarur të Sigurisë së Limituar si "Raporti") për vitin fiskal të përfunduar më 31 dhjetor 2022 ("të dhëna të përzgjedhura"), në mënyrë që të ofrohet siguri e limituar në lidhje me kriteret e përshkuara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllime të këtij Raporti të Pavarur të Sigurisë së Limituar, të dhënat e përzgjedhura kanë të bëjnë me aktivitetin e Shoqërisë në vitin 2022 dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me shoqëri të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / veprime të palëve të treta.

### Qëllimi i punës

Angazhimi i sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurimit 3000: Angazhimet e sigurisë të ndryshme nga auditimet ose rishikimet e informacionit financiar historik ("ISAE 3000"), në mënyrë që të ofrohet opinion i një niveli të limituar sigurie mbi:

- Metodologjinë e vlerësimit të materialitetit në lidhje me udhëzimet e standardit AA1000 dhe më specifikisht procesin e ndjekur nga Shoqëria në lidhje me identifikimin dhe priorizimin e Çështjeve Materiale më të rëndësishme.
- Plotësinë dhe saktësinë e deklarimeve jo-financiare cilësore dhe sasore të qëndrueshmërisë, në veçanti për fushat e Performancës Mjedisore dhe Sociale, dhe në lidhje me kriteret e zbatueshme në vitin 2022 në nivel grupi ("Kriteret e Raportimit", shërbimet ilustruar në Raportin Vjetor të Integruar të Grupit të vitit 2022), të cilat janë në përputhje me udhëzimet sektoriale dhe standardet e raportimit dhe me kuadrin specifik udhëzues dhe standardet e raportimit të zhvilluara nga TITAN Group. Të gjitha informacionet shpjeguese për raportimin mbi Performancën Mjedisore dhe Sociale në nivel njësie biznesi janë në përputhje me Standardet e Grupit, të cilat janë të përfshira në proceset e implementuara. Më specifikisht, informacionet shpjeguese dhe indikatorët për:
  - Performanca Mjedisore është vendosur në të gjithë aspektin material në përputhje me Kriteret e Raportimit dhe në veçanti me Udhëzimet përkatëse të Kuadrit të Qëndrueshmërisë GCCA.
  - Performanca sociale, që mbulon sa vijon: Shëndeti dhe Siguria, ku nivelet e bizneseve të TITAN ndjekin Udhëzimet e Kuadrit të Qëndrueshmërisë GCCA, Zhvillimin e Personelit (për orët e trajnimit të punonjësve) dhe Angazhimin e Komunitetit (sipas objektivit të Grupit për të gjitha operacionet kryesore që kanë të bëjnë me planet e angazhimit të komunitetit në përputhje me çështje materiale për palët e interesuara dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm).
- Konsistenca e informacioneve shpjeguese jo-financiare cilësore dhe sasore të paraqitura, të cilat ofrojnë dëshmi për respektimin e Dhjetë Parimeve të UNGC, dhe në veçanti për fushat e Performancës Mjedisore dhe Sociale.

## Përgjegjësitë e drejtimit

Shoqëria ANTEA CEMENT sh.a. është përgjegjëse për përgatitjen, paraqitjen, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave jo-financiare që na janë dhënë, siç janë përfshirë në Raport. Kjo përgjegjësi përfshin gjithashtu zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme për përgatitjen e Raportit dhe përdorimin e supozimeve dhe vlerësimeve për informacionet shpjeguese individuale të qëndrueshmërisë, të cilat janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse. Për më tepër, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e të dhënave dhe kontrolleve të brendshme adekuate që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit. Në veçanti, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për kontrollet e brendshme që po hartohen dhe zbatohen për të parandaluar raportimin nga keq deklarimi material.

## Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është të kryejmë një angazhim të pavarur të sigurisë së limituar në mënyrë që të shprehim një përfundim bazuar në procedurat e kryera për të dhënat e përzgjedhura, siç përshkruhet në seksionin "Qëllimi i punës" më sipër.

Puna jonë është kryer në përputhje me ISAE 3000 "Angazhimet e sigurisë të ndryshme nga auditimet ose rishikimet e informacionit financiar historik", të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Ky standard kërkon që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike nga Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionalë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët, si dhe të planifikojmë dhe të kryejmë një angazhim të pavarur të sigurisë së limituar në një mënyrë që do të na lejojë të shprehim një përfundim me siguri të limituar.

Një angazhim me siguri të limituar është i kufizuar kryesisht në pyetje dhe procedura analitike. Procedurat e kryera në një angazhim të sigurisë së limituar ndryshojnë në natyrë dhe kohë dhe janë më të vogla në shtrirje sesa për një angazhim të sigurisë së arsyeshme. Rrjedhimisht, niveli i sigurisë së marrë në një angazhim të sigurisë së limituar është në thelb më i vogël në fushëveprim sesa një angazhim i sigurisë së arsyeshme i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Angazhimeve të Sigurisë. Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne as nuk pranojmë dhe as marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë ose këtë raport ndaj dikujt tjetër përveç Shoqërisë dhe Grupit TITAN, përveç rasteve kur kushtet janë rënë dakord shprehimisht me shkrim, me pëlqimin tonë paraprak.

## Përmbledhje e punës së kryer

Në kuadër të punës sonë, ndër të tjera kemi kryer procedurat e mëposhtme në lidhje me analizën e materialitetit, qasjet e drejtimit dhe të dhënat kryesore të paraqitura në Raport:

- Lexim i Raportit të Qëndrueshmërisë (në tërësinë e tij) për t'u siguruar që është në përputhje me kriteret e detajuara në seksionin "Qëllimi i punës" në këtë raport të pavarur të sigurisë së limituar;
- Intervista me personelin kryesor përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Qëndrueshmërisë, duke marrë informacion mbi performancën e qëndrueshmërisë për të kuptuar dhe vlerësuar proceset, kontrollet e brendshme dhe sistemet e informacionit në lidhje me përgatitjen e informacionit të lartpërmendur;
- Kuptimi i Shoqërisë në lidhje me strukturën e saj organizative të qëndrueshmërisë, dialogun e palëve të interesuara dhe procesin e zhvillimit të programit të qëndrueshmërisë;
- Krahasimi i tekstit dhe të dhënave (në bazë të përzgjedhjes) të paraqitura në Raportin e Qëndrueshmërisë me burimet themelore. Kjo përfshin marrjen parasysh nëse të gjitha çështjet materiale janë përfshirë dhe nëse teksti dhe të dhënat e raportuara janë nxjerrë me saktësi nga informacioni themelor.

## Limitimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetëm ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Shoqërisë, të cilin ne e pranuan në mirëbesim si të plotë, të saktë, real dhe jo mashtrues.

- Prandaj, ne nuk e kemi dorëzuar atë në asnjë procedurë verifikimi, përveç procedurave të shprehura në mënyrë eksplicite në Raportin tonë dhe të cilat dalin nga metodologjia jonë e dakordësuar në mënyrë reciproke.
- Nuk është bërë asnjë punë për të dhënat për periudhat e mëparshme raportuese, si dhe për të dhënat në lidhje me parashikimet dhe objektivat.
- Asnjë punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe rrjedhimisht, opinioni ynë është i limituar në atë fushë.

## Pavarësia jonë dhe kontrolli i cilësisë

Grant Thornton zbaton kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1. Bazuar në këtë, ai mban një sistem të integruar të kontrollit të cilësisë që përfshin politika dhe procedura për përputhjen me parimet morale, standardet profesionale dhe kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe standardet e tjera etike të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionalë të IFAC të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmërisë, përshtatshmërisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi i angazhimit të sigurisë është i pavarur nga Shoqëria dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit.

## Konkluzionet me siguri të limituar

Bazuar në procedurat e kryera dhe provat e marra, asgjë nuk është konstatuar që na ka bërë të besojmë se ka ndonjë gabim apo anomali që do të ndikonte materialisht në të dhënat dhe informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin e ANTEA CEMENT sh.a. (duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe referencat përkatëse) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022. Gjithashtu, asgjë nuk është konstatuar që të na shtyjë të mendojmë se të dhënat jo-financiare të paraqitura nuk janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më sipër, në rubrikën "Qëllimi i punës".

Grant Thornton sh.p.k., 16 / 06 /2023

Auditues Ligjor

*Kledian Koka, Rced*



## FJALOR

**CAPEX:** Blerjet/shtimet e pronave, fabrikave dhe pajisjeve, aktiveve me të drejtë përdorimi, pasurive për investime dhe aktiveve jo-materiale. Kjo gjë i lejon drejtuesit që të monitorojnë shpenzimet e kapitalit.

**EBITDA:** Fitimi operacional para humbjeve nga zhvlerësimi i emrit të mirë plus amortizimi, amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve materiale dhe jo-materiale dhe amortizimi i granteve qeveritare. Siguron një masë të përfitueshmërisë operationale që është e krahasueshme me segmentet që raportohen vazhdimisht.

**AQUEDUCT:** Atlasi i Rrezikut të Kanaleve të Ujërave (Aqueduct Water Risk Atlas) nga Instituti i Burimeve Botërore (WRI) është një bazë e të dhënave globale që janë në dispozicion të publikut në internet lidhur me treguesit e rrezikut të ujit në nivel lokal dhe një standard global për matjen dhe raportimin e rrezikut gjeografik të ujit. Instituti i Burimeve Botërore është një organizatë kërkimore globale, e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse, i cili ka si mision inkurajimin e shoqërisë njerëzore që të jetojë në mënyra që mbrojnë mjedisin e Tokës dhe kapacitetin e saj për të siguruar nevojat dhe aspiratat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. Linku: <https://www.wri.org/aqueduct>

**CDP:** është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse e ndikimit mjedisor, që ofron një platformë për shoqëritë, qytetet, shtetet dhe rajonet për të raportuar informacione mbi ndikimet e tyre klimatike, shpyllëzimin dhe sigurinë e ujit. Ekonomia globale e konsideron CDP-në si standardin e artë të raportimit mjedisor. Ai mban të dhënat më të pasura dhe më gjithëpërfshirëse në botë se si shoqëritë, qytetet, shtetet dhe rajonet matin, kuptojnë dhe adresojnë ndikimet e tyre mjedisore. CDP-ja synon të bëjë raportimin mjedisor në rrjedhën e përgjithshme, duke ofruar njohuri dhe analiza të detajuara për të nxitur veprimet urgjente të nevojshme për një botë të sigurt për klimën, pa shpyllëzime dhe me ujë të sigurt. Linku: <https://www.cdp.net/en>

**COP:** Komunikimi mbi Progresin është menduar si një mekanizëm për të informuar, në një format të standardizuar të një raporti vjetor, palët e interesuara të shoqërisë (p.sh., investitorët, konsumatorët, shoqërinë civile dhe qeveritë) rreth ecurisë lidhur me zbatimin e Dhjetë Parimeve të Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara.

**CSR Europe:** Rrjeti lider evropian i biznesit për qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë e korporatave. Rrjeti mbështet bizneset dhe sektorët e industrisë për transformimin dhe bashkëpunimin e tyre drejt zgjidhjeve praktike dhe rritjes së qëndrueshme. Ambicia është ndryshimi sistematik; prandaj, duke ndjekur OZHQ-të, rrjeti kërkon të hartojë së bashku me udhëheqësit dhe palët e interesuara evropiane një strategji gjithëpërfshirëse për një Evropë të Qëndrueshme 2030.

**IIRC:** Këshilli Ndërkombëtar i Raportimit të Integruar është një koalicion global i rregullatorëve, investitorëve, shoqërive, përcaktuesve të standardeve, profesionit të kontabilitetit, akademisë dhe OJQ-ve. Koalicioni promovon komunikimin rreth krijimit të vlerës si hapi tjetër në zhvillimin e raportimit

të korporatës. Linku: <https://www.integratedreporting.org/>

**SASB:** Bordi i Standardeve të Qëndrueshmërisë së Kontabilitetit është një bord i pavarur standardesh që është përgjegjës për procesin e duhur, rezultatet dhe ratifikimin e standardeve të tij, zbatimin e të cilit (duke qenë misioni i SASB) është të ndihmojë bizneset në mbarë botën të identifikojnë, menaxhojnë dhe raportojnë mbi temat e qëndrueshmërisë që përbëjnë më shumë rëndësi për investitorët e tyre. Linku: <https://www.sasb.org/>

**SBTi:** SBTi është një partneritet midis CDP, Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara, Institutit të Burimeve Botërore (IBB) dhe Fondit Botëror për Natyrën (WWF). Qëllimi i SBTi është të përgatisë shoqëritë për të udhëhequr veprimet urgjente klimatike dhe t'i udhëzojë ato në përcaktimin e objektivave që bazohen në shkencë, të cilat mund të kufizojnë ngrohjen globale në 1.5°C, të arrijnë një botë me gaz serre të balancuar jo më vonë se në vitin 2050 dhe të parandalojnë efektet më negative të ndryshimeve klimatike. Linku: <https://sciencebasedtargets.org/>

**SDGs:** Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një përmbledhje e 17 qëllimeve globale që janë krijuar për të qenë një "projekt për të arritur një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë". OZHQ-të, e përcaktuara në vitin 2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe që synohen të arrihen deri në vitin 2030, janë pjesë e Rezolutës 70/1 të OKB, Agjenda e 2030. Linku: <https://unric.org/en/united-nations-sustainable-development-goals/>

**TCFD:** Themeluar nga Bordi i Qëndrueshmërisë Financiare në vitin 2016, Task Forca për Zbulimet Financiare të ndërlidhura me Klimën është një koalicion i drejtuar nga tregu, misioni i të cilit është të zhvillojë zbulime vullnetare, të qëndrueshme të rrezikut financiar që lidhen me klimën për përdorim nga shoqëritë në ofrimin e informacionit për palët e interesuara (si investitorët, huadhënësit dhe siguruesit).

**UNCTAD:** Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillim është një organ i Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për trajtimin e çështjeve ekonomike dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, e cila ka në fokus tregtinë, financat, investimet dhe teknologjinë, veçanërisht për të ndihmuar vendet në zhvillim që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në ekonominë globale. Linku: <https://unctad.org/publication/guidance-core-indicatorssustainability-and-sdg-impact-report>

**UNGC:** Pakti Global i Kombeve të Bashkuara është një nismë vullnetare që bazohet në angazhimet e CEO, qëllimi i të cilit është të vejë në zbatim parimet universale të qëndrueshmërisë ("Dhjetë Parimet") dhe të ndërmarrë hapa për të mbështetur qëllimet e OKB. "Dhjetë Parimet" rrjedhin nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë, Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit. Linku: <https://unglobalcompact.org/>

**WBCSD:** Këshilli Botëror i Biznesit për Zhvillim të Qëndrueshëm është një organizatë globale që drejtohet nga CEO e mbi 200 bizneseve lider që punojnë së bashku për të përshpejtuar tranzicionin në një botë të qëndrueshme, duke ndihmuar shoqëritë anëtare të bëhen më të suksesshme dhe të qëndrueshme duke u fokusuar në ndikimin maksimal pozitiv për aksionarët, mjedisin dhe shoqëritë.

**WRI:** Instituti i Burimeve Botërore është një organizatë kërkimore globale, e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse, i cili ka si mision inkurajimin e shoqërisë njerëzore që të jetojë në mënyra që mbrojnë mjedisin e Tokës dhe kapacitetin e saj për të siguruar nevojat dhe aspiratat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. Linku: <https://www.wri.org/>



**ANTEA CEMENT SH.A**  
Address: Rr. Durrësit, Pallati prapa  
Ring Center, Kati 1, 1001,  
Tirana, Albania  
P.O. BOX 1746

Tel: +355 (0) 4450 2490  
Tel: +355 (0) 4450 2480  
Fax: +355 (0) 44502412  
Email: [info@anteacement.com](mailto:info@anteacement.com)